



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE

Nr. 5297 Prot.

Tiranë, më 04.04 2025

URDHËR

Nr. 551, Datë 04.04 2025.

**PËR MIRATIMIN
E RREGULLORES SË BRENDSHME MBI TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË
DËNUARVE ME BURGIM DHE TË PARABURGOSURVE**

Drejtorive të institucioneve të zbatimit të vendimeve penale
Drejtorive dhe sektorëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve

Bazuar në Ligjin Nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", neni 52, pika 1; Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, të miratuar me VKM Nr.209, datë 06.04.2022, neni 112 *me qëllim* përcaktimin e rregullave për një zbatim efikas dhe të drejtë të legjislacionit në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale me burgim, në funksion të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, rehabilitimit dhe riintegritit social.

URDHËROJ

1. Miratimin e Rregullores së brendshme mbi të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve sipas lidhjes bashkëlidhur.
2. Të gjithë Drejtoritë e IEVP-ve, të organizojnë punën me punonjësit për njohjen dhe zbatimin e rregullores si dhe informimin e të dënuarve dhe paraburgosurve.
3. Rregullorja do të jetë në proces rishikimi, për një periudhë tre muaj nga data e miratimit, me qëllim që të reflektohen konstatimet, vërejtjet dhe rekomandimet për përmirësim.
4. Drejtoritë e IEVP-ve dhe të DPB gjatë periudhës së zbatimit të rregullores, të përcjellin pranë DPB, vërejtjet dhe rekomandimet për përmirësimin e saj.
5. Rregulloret e brendshme të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, të miratuara me Urdhër numër 5391/1 datë 22.06.2010; 5390/1 datë 22.06.2010; 5395/1 datë 15.06.2010; 5402/1 datë 15.06.2010; 5397/1 datë 22.06.2010; 5393/1 datë 22.06.2010; 5396/1 datë 22.06.2010; 5392/1 datë 22.06.2010; 7157/3 datë 03.12.2012;

- 5394/1 datë 22.06.2010; 5400/1 datë 22.06.2010; 5403/1 datë 22.06.2010; 5387/1 datë 22.06.2010; 5389/1 datë 22.06.2010; 5401/1 datë 22.06.2010, shfuqizohen.
6. Për institucionet e veçanta, si; IEVP Pojskë, IM Kavajë, Institucioni i Posaçëm Shëndetësor Lezhë dhe Qendra Spitalore e Burgjeve, të hartohen rregullore të veçanta.
7. Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas datës së miratimit.

DREJTORI I PERGJITHSHEM

KLEVIS QOSE



RREGULLORE E BRENDSHME
MBI
TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM
DHE
TË PARABURGOSURVE

KAPITULLI I
DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Rregullorja e brendshme mbi të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, parashikon, rregullat për trajtimin, regjimin dhe sjelljen e të burgosurve në institucion, në përputhje me parashikimet ligjore¹.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është të mirë përcaktojë rregullat për një zbatim efikas dhe të drejtë të Ligjit Nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, të miratuar me VKM Nr. 209 datë 06.04.2022 dhe legjislacionit në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale me burgim në Republikën e Shqipërisë, në funksion të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, rehabilitimit dhe riintegritimit social.

Neni 3

Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet në të gjitha Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP);

- a. për personat e dënuar me burgim, gjysmë liri, dhe të paraburgosur.
- b. për të burgosurit të cilët qëndrojnë përkohësisht jashtë IEVP.
- c. për stafin, lidhur me detyrimet dhe përgjegjësitë e shërbimit.

Neni 4

Trajtimi i ndryshëm dhe i përligjur i të burgosurve

Mbështetja ndaj të burgosurve të sëmurë, të moshuar, shtetas të huaj, të pambrojtur është e përligjur dhe nuk përbën trajtim preferencial.

Stafi vendos masat e sigurisë, sipas parashikimeve në ligj, në përputhje me shkallën e rrezikshmërisë së të burgosurve, në funksion parandalues dhe të garantimit të rendit dhe sigurisë.

Kufizimet lidhur me regjimin e posaçëm të sigurisë së lartë nuk mund të jenë përtej parashikimeve ligjore.

KAPITULLI II
KRITERET E VENDOSJES SË TË DËNUARVE SIPAS VLERËSIMIT TË SIGURISË NË
IEVP

¹ Neni 52 pika 1 e Ligjit Nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

Neni 5

Vendosja e të burgosurve sipas nivelit të sigurisë

1. Bazuar në vlerësimin e rrezikshmërisë dhe të nevojave, të burgosurit vendosen në nivele të sigurisë sipas parashikimit të Ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”
2. Regjimi i posaçëm në sigurinë e lartë vendoset në institucione ose seksione të veçanta dhe zbatohet sipas parashikimeve në Ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
3. Të burgosurit bashkëpunëtorë dhe dëshmitarë të drejtësisë mbahen në seksione të veçanta, parashikuar në Ligjin Nr. 10173 datë 22.10.2009 “Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë” *i ndryshuar*, Marrëveshjen ndërmjet DPB dhe Policisë së Shtetit.
4. Të burgosurit që kanë risk për shkak të profesionit apo detyrave që kanë kryer, sigurohen në seksione të ndarë nga të burgosurit e tjerë.

Neni 6

Institucioni i sigurisë së lartë

1. Në institucionet apo seksionet e sigurisë së lartë, vendosen kategoria e të dënuarve që parashikohen në nenin 16 të Ligjit Nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
2. Bazuar në vlerësimin e rrezikshmërisë, të dënuarit e sigurisë së lartë klasifikohen në tre regjime:
 - a. Regjimi bazë
 - b. Regjimi standart
 - c. Regjimi i zgjeruar
3. Transferimi nga një regjim më i lartë në një regjim më të ulët dhe anasjelltas kryhet me miratim të drejtorit të IEVP, pas vlerësimit të kryer nga komisioni, si dhe plotësimit të kriterëve në formularin standart.
4. Brenda sigurisë së lartë krijohet regjimi i posaçëm, i cili funksionon sipas parashikimit në nenin 17 të Ligjit Nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”
5. Të burgosurit bashkëpunëtorë dhe dëshmitarë të drejtësisë mbahen në seksion të veçantë.

Neni 7

Regjimi bazë i sigurisë së lartë

1. Në regjimin bazë të sigurisë së lartë, mbahen të burgosur, arratisja e të cilëve do të ishte shumë e rrezikshme për sigurinë kombëtare, për publikun, ose sigurinë e shtetit dhe duhet të merren masa për pamundësimin e arratisjes së tyre.
2. Të dënuarit e sigurisë së lartë mbahen në regjimin bazë të sigurisë nga fillimi i ekzekutimit të vendimit penal në sigurinë e lartë deri kur plotësojnë një të tretën (1/3) e dënimit të dhënë dhe pavarësisht nga koha e dënimit të kryer, mbahet në këtë regjim gjithashtu kur:
 - a. ka kryer, tentative për t’u arratisur, akte dhunë që kanë sjellë pasoja të rënda për jetën ose shëndetin e stafit, të burgosurve apo vizitorëve, gjatë gjithë vuajtjes së dënimit.
 - b. ka kryer shkelje shumë të rënda sipas parashikimit të nenit 88 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, në pesë (5) vitet e fundit.

- c. ka kryer shkelje të rënda sipas parashikimit të nenit 88 të Rregullores së Përgjithshme në dy (2) vitet e fundit.
 - d. disponohen të dhëna dhe prova për veprime dhe mosveprime si dhe sjellje, në kundërshtim me rregulloren e përgjithshme të burgjeve.
3. Të dënuarve në regjimin bazë të sigurisë së lartë, ju garantohen të drejtat e përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve në lidhje me vizitat, telefonatat, sigurimin e ushqimit, veshjeve, trajtimin shëndetësor, ajrimin, përfshirjen në programe rehabilituese.

Neni 8

Regjimi standard i sigurisë së lartë

1. Të dënuarit e sigurisë së lartë mbahen në regjimin standard të sigurisë kur kanë kryer më shumë se një të tretën (1/3) e dënimit të dhënë dhe nuk ka prova për veprime dhe mosveprime si dhe sjellje, në kundërshtim me rregulloren e përgjithshme të burgjeve. Nuk ka kryer asnjë nga shkeljet e parashikuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje. Të dënuarit me burgim të përjetshëm mund të vendosen në regjimin standard, sipas kriterëve të parashikuara në këtë Rregullore, kur kanë kryer mbi 10 vite burgim.
2. Vendimi për transferimin e të dënuarit nga regjimi bazë në regjimin standard të sigurisë së lartë, shoqërohet me vlerësimin e sjelljes dhe të rrezikshmërisë, sipas formatit të vlerësimit.
3. Të dënuarve në regjimin standard të sigurisë së lartë, ju garantohen të drejtat e përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve në lidhje me vizitat, telefonatat, sigurimin e ushqimit, veshjeve, trajtimin shëndetësor, ajrimin, përfshirjen në programe rehabilituese. Drejtoria e Institucionit mban në konsideratë zgjatjen e kohës së ajrimit, të dhënies së një vizite shtesë, të punësimit brenda institucionit, sipas mundësive që lejon infrastruktura.

Neni 9

Regjimi i zgjeruar i sigurisë së lartë

1. Të dënuarit e sigurisë së lartë mbahen në regjimin e zgjeruar të sigurisë kur ju ka mbetur më pak se një e pesta (1/5) për të përfunduar dënimin e dhënë dhe nuk ka prova për veprime dhe mosveprime si dhe sjellje, në kundërshtim me rregulloren e përgjithshme të burgjeve.
2. Të dënuarit e sigurisë së lartë, të cilët janë me moshë mbi 60 vjeç ose kanë një paaftësi shëndetësore, mbahen në regjimin e zgjeruar të sigurisë së lartë, me përjashtim të rasteve kur subjektet janë përfshirë në shkelje të rënda të rregullores. Të burgosurit e sigurisë së lartë, të cilët janë paraplegjik dhe tetraplegjik ose kanë çrregullime të rënda mbahen në Seksion të Kujdesit të Veçantë, ku ka staf mjekësor dhe kujdestar.
3. Të dënuarit që vlerësohen për t'u vendosur në regjimin standart të sigurisë së lartë, si rregull mbahen në seksione të ndryshme nga të dënuarit e regjimit bazë të sigurisë.
4. Të dënuarit që vlerësohen për t'u vendosur në regjimin e zgjeruar të sigurisë së lartë, mbahen në seksione të ndryshme nga të dënuarit e regjimit bazë të sigurisë dhe si rregull, transferohen në një institucion tjetër të sigurisë së lartë, kur nuk ka pengesa të tjera, siç mund të jenë largësia me vendbanimin.
5. Të dënuarve në regjimin e zgjeruar të sigurisë së lartë, ju garantohen të drejtat e përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve në lidhje me vizitat, telefonatat, sigurimin e ushqimit, veshjeve, trajtimin shëndetësor, ajrimin, përfshirjen në programe rehabilituese. Drejtoria e Institucionit mban në konsideratë zgjatjen e kohës së ajrimit, të dhënies së një vizite shtesë, të

punësimit brenda institucionit, sipas mundësive që lejon infrastruktura dhe planifikimin e të dënuarit për leje shpërblyese, sipas kriterëve ligjorë.

6. I dënuari i regjimit të zgjeruar të sigurisë së lartë, mund të transferohet në sigurinë e zakonshme, me vendim gjykatë, bazuar në kërkesën e tij, avokatit të tij, apo të Drejtorisë së IEVP, kur ka demonstruar sjellje pozitive, gatishmëri për t'u përfshirë në programe rehabilituese dhe kur rezulton pa rekorde disiplinore.

Neni 10

Siguria e zakonshme

1. Në institucionet apo seksionet e sigurisë së zakonshme, vendosen kategoria e të dënuarve që parashikohen në nenin 18 të Ligjit Nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".
2. Të dënuarve në sigurinë e zakonshme, ju garantohen të drejtat e përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve në lidhje me vizitat, telefonatat, sigurimin e ushqimit, veshjeve, trajtimin shëndetësor, ajrimin, përfshirjen në programe rehabilituese, punësimin. Drejtoria e Institucionit mban në konsideratë zgjatjen e kohës së ajrimit, të dhënies së një vizite shtesë, të punësimit brenda institucionit, sipas mundësive që lejon infrastruktura dhe planifikimin e të dënuarit për leje shpërblyese, sipas kriterëve ligjorë.

Neni 11

Siguria e ulët

1. Transferimi i të dënuarit nga siguria e zakonshme në institucionin, apo seksionet e sigurisë së ulët, kryhet pasi janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet si vijojnë:
 - a. Janë dënuar për kundërvajtje penale, për vepra penale nga pakujdesia dhe për vepra të tjera penale, dënimi i të cilave nuk i kalon pesë vjet burgim dhe i dënuari ka kryer jo më pak se 2/3 e dënimit.
 - b. I dënuari është vlerësuar me risk të ulët për arratisje, për shoqërinë dhe komunitetin, për rishkelje.
 - c. Nuk ka asnjë histori të mëparshme të përpjekjes për t'u arratisur.
 - d. Mban qëndrim pendesë ndaj veprës penale dhe nuk mbështet mendimet kriminale;
 - e. Nuk ka kryer shkelje disiplinore të klasifikuara si shumë të rënda apo të rënda, sipas parashikimit të nenit 62 të Ligjit 81/2020 dhe nenit 88 të VKM nr.209/2022 në dy vitet e fundit.
 - f. Nuk ka kontakte me të burgosurit e përfshirë në organizata të krimit të organizuar ose grupe terroriste.
 - g. Gjatë kryerjes së dënimit është përfshirë vullnetarisht në aktivitete arsimimi dhe formimi profesional, programe rehabilituese dhe rekreative dhe ka dëshmuar përparim.
2. Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë në DPB vendos për revokimin e vendimit për transferimin e të dënuarit në sigurinë e ulët në rast se gjatë qëndrimit në regjimin e sigurisë së ulët i dënuari:
 - a. ka kryer tentativë për t'u arratisur;
 - b. ka kryer akte dhunë që kanë sjellë pasoja për jetën ose shëndetin e stafit, të burgosurve apo vizitorëve;
 - c. ka kryer shkelje të rënda dhe shumë të rënda disiplinore sipas parashikimit të nenit 62 të Ligjit 81/2020 dhe nenit 88 të VKM nr.209/2022;
 - d. kryen shkelje të përsëritura disiplinore qoftë edhe të lehta;

- e. disponohen të dhëna dhe prova objektive për sjellje, veprime dhe mosveprime, në kundërshtim me rregulloren e përgjithshme të burgjeve, të cilat pamundësojnë qëndrimin e mëtejshëm të të dënuarit në sigurinë e ulët;
3. Të dënuarit që vlerësohen për t'u vendosur në regjimin e sigurisë së ulët, mbahen në seksione të ndryshme nga të dënuarit e sigurisë së zakonshme.
4. Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë në DPB dhe Drejtoria e IEVP kërkojnë informacione nga agjensitë ligjzbatuese për të burgosurit e sigurisë së ulët, kur ka të dhëna dhe dyshime për përfshirje në veprimtari kriminale dhe i vlerëson ato rast pas rasti.
5. Të dënuarve në sigurinë e ulët, ju garantohen të drejtat e përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve në lidhje me vizitat, telefonatat, sigurimin e ushqimit, veshjeve, trajtimin shëndetësor, ajrimin, përfshirjen në programe rehabilituese, punësimin. Drejtoria e Institucionit mban në konsideratë zgjatjen e kohës së ajrimit, të dhënies së një vizite shtesë, të punësimit brenda dhe jashtë institucionit, sipas mundësive që lejon infrastruktura dhe planifikimin e të dënuarit për lejë shpërblyese, sipas kriterëve ligjore.

Neni 12

Institucion i hapur²

1. “Institucion i hapur” është institucioni ose seksioni jashtë perimetrit të sigurisë në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, në të cilin i dënuari kryen dënimin me mbikëqyrje dhe nivel minimal sigurie duke mos u mbyllur në ambjentet e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale.
2. Institucionet, ose seksionet e hapura menaxhohen bazuar në ndjenjën e vetëdisiplinës, vetëbesimit, vetëpërgjegjësisë së të burgosurve.
3. Të dënuarit mund të dalin gjatë ditës për punë, edukim/trajnim, sipas planit individual të trajtimit dhe të kthehen në darkë.
4. “Institucionet e hapura”, janë të hapura për publikun, pasi familjarët mund të vizitojnë të dënuarit.
5. Në institucionet ose seksionet e hapura nuk ka mbyllje të dyerve, zgara, pengesa të tjera për arratisje dhe ka shërbime mbikëqyrje minimale.

Neni 13

Kriteret për transferimin e të dënuarit në institucionin e hapur

1. Në institucionin e hapur vendosen të dënuarit, sipas parashikimit të nenit 20 të Ligjit Nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe të dënuarit me gjysmë liri, sipas nenit 58 të Kodit Penal.
2. Transferimi në një institucion të hapur, ose seksione të hapura bëhet vetëm për të dënuarit me burgim, ekzekutimi i dënimit të të cilit bëhet në një institucion, ose seksione të sigurisë së ulët.
3. Kërkesa për transferim bëhet nga drejtori i institucionit ku ekzekutohet dënimi, i dënuari ose përfaqësuesi i tij ligjor, dhe miratohet nga Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve.
4. Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë në DPB vendos për kalimin e të dënuarit nga siguria e ulët në një institucion të hapur, pasi janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet si mëposhtë:
 - a. Të dënuarit i ka mbetur më pak se gjashtë muaj burgim për të vuajtur nga dënimi i dhënë.
 - b. I dënuari është vlerësuar me risk të ulët për arratisje, për shoqërinë dhe komunitetin, për ri shkelje.
 - c. Nuk ka asnjë histori të mëparshme të përpjekjes për t'u arratisur.

² Neni 3, pika 6 e Ligjit Nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”

- d. I dënuari nuk mbështet mendimet kriminale;
 - e. Nuk ka kryer shkelje disiplinore të klasifikuara si shumë të rënda apo të rënda, sipas parashikimit të nenit 62 të Ligjit 81/2020 dhe nenit 88 të VKM nr.209/2022 në dy vitet e fundit.
 - f. Nuk ka kontakte me të burgosurit e përfshirë në organizata të krimit të organizuar ose grupe terroriste.
 - g. Gjatë kryerjes së dënimit është përfshirë vullnetarisht në aktivitete arsimimi dhe formimi profesional, programe rehabilituese dhe rekreative dhe ka dëshmuar përparim.
5. Krahas kriterëve të vendosura në pikat 1, 2, të këtij urdhri, për vendosjen në një burg me regjim të hapur i burgosuri duhet gjithashtu:
- a. Të karakterizohet nga sensi i përgjegjësisë për veten, familjen dhe komunitetin.
 - b. Të jetë i motivuar të përfshihet në punësim sipas mundësive të punësimit të komunitetit.
 - c. Të jetë i gatshëm që të përmbushë detyrimet e vendosura nga gjykata, nëse ka (kompensim i viktimave)
6. Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë në DPB vendos revokimin e vendimit për transferimin e të dënuarit nga burgu i sigurisë së ulët në Institucion të hapur, në rast se i burgosuri:
- a. shkel rregulloren e përgjithshme të burgjeve ose rregulloren e brendshme të institucionit
 - b. disponohen të dhëna dhe prova objektive për sjellje, veprime dhe mosveprime, të cilat pamundësojnë qëndrimin e mëtijshëm të të dënuarit në një burg të hapur;
 - c. ka kryer tentativë për t'u arratisur;
 - d. ka kryer akte dhunë që kanë sjellë pasoja për jetën ose shëndetin e stafit, të burgosurve, vizitorëve apo komunitetin;
 - e. ka kryer shkelje të rënda dhe shumë të rënda disiplinore sipas parashikimit të nenit 62 të Ligjit 81/2020 dhe nenit 88 të VKM nr.209/2022;
 - f. kryen shkelje të përsëritura disiplinore qoftë edhe të lehta.
7. Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë në DPB dhe Drejtoria e IEVP kërkojnë informacione nga agjensitë ligjzbatuese për të burgosurit në burg të hapur, kur ka të dhëna dhe dyshime për përfshirje në veprimtari kriminale dhe i vlerëson ato rast pas rasti.

Neni 14

Të drejtat dhe privilegjet në institucionin e hapur

1. Të drejtat dhe privilegjet e të dënuarve në institucionin/seksionin e hapur janë:
 - a. Vizita familjare deri në tetë (8) herë në muaj nga një (1) orë;
 - b. Telefonatat e pakufizuara sipas orarit të përcaktuar
 - c. Blerje nga operatori ekonomik i kontraktuar, sipas listës së artikujve të lejuar në vlerë deri në 8000 (tetë mijë) lekë në javë;
 - d. Ajrosje në ambientet e përcaktuara, pa kufizim gjatë ditës.
 - e. TV, mjet ftohës dhe pajisje të lejuara për ngrohje apo gatim si dhe lojëra në dhomë të banimit
 - f. Aktivitetet sportive në sallë dhe fusha sportive;
 - g. Mundësi që të punojë jashtë perimetrit të sigurisë të Institucionit pa mbikëqyrje;
 - h. E drejta në edukim dhe trajnime profesionale edhe jashtë institucionit;
 - i. E drejta në komunikim elektronik online
 - j. Mundësi të punësimit jashtë Institucionit;

Neni 15

Detyrimet e të dënuarve gjatë punës jashtë dhe brenda institucionit

1. Të dënuarit që aktivizohen në punë brenda ose jashtë institucionit, duhet të zbatojnë këto rregulla:
 - a. Të zbatojnë orarin e punës, sipas kontratës.
 - b. Të respektojnë rregullat e punës për ruajtje dhe mirëmbajtje të pajisjeve dhe mjeteve të punës dhe të mbajnë pastër vendin e punës.
 - c. Ndalohen komunikimet përveç personave të lidhur me punën apo institucionin.
 - d. Të përdorin uniformën e punës dhe mjetet mbrojtëse.
 - e. Ndalohet largimi pa lejë nga vendi i punës.
 - f. Të raportojë çdo problem që konstaton lidhur me shkelje të këtyre rregullave, si dhe kontakte që mund të ketë patur gjatë punës.
 - g. Ndalohet blerja dhe përdorimi i pijeve alkoolike
 - h. Të dënuarit duhet të sillen me etikë.
2. Transporti për në vendin e punës mbulohet me shpenzimet e të dënuarit dhe lejohet përdorimi i transportit publik, apo automjeteve personale. Institucioni nuk mban përgjegjësi për sigurimin e parkimit apo ruajtjen e automjeteve të të dënuarve.

Neni 16

Pagesat dhe shpenzimet

1. Të dënuarve në institucionin e hapur ju lejohet të mbajnë kartë debiti në të cilën kanë një sasi të limituar parash, që tu nevojiten për shpenzime ditore.
2. Pagesat për të dënuar që punojnë jashtë institucionit janë sipas kontratës, por jo më të ulta se paga minimale.
3. Pagesat për të dënuarit që punojnë brenda institucionit, apo në shërbime të tjera për llogari të institucionit janë 25% e pagës minimale në shkallë kombëtare.
4. Të dënuarit që punojnë jashtë institucionit, me kontratë kanë të drejtë të shpenzojnë deri në 8000 (tetëdhjetë mijë lekë) në javë, vetëm për artikuj të parashikuar.

KREU III

REGJIMI I POSAÇËM I SIGURISË SË LARTË NË IEVP

Neni 17

Baza ligjore

Regjimi i posaçëm funksionon sipas parashikimeve të nenit 17 të Ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe Kreu VI i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me VKM Nr.209, datë 06.04.2022.

Neni 18

Ambientet ku zbatohet regjimi i posaçëm

1. Regjimi i posaçëm në burgun e sigurisë së lartë, është seksioni i përcaktuar për mbajtjen e personave të dënuar ose të paraburgosur, të cilët me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë, sipas Nenit 17 të Ligjit nr. 81/2020, janë vendosur nën regjimin e posaçëm.
2. Regjimi i Posaçëm, hapet në seksione të IEVP-ve të sigurisë së lartë, që nuk ka asnjë lidhje dhe mundësi kontakti me seksionet e tjera.

3. Seksioni ku zbatohet Regjimi i Posaçëm miratohet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 19

Procedurat e pranimit të dënuarve/paraburgosurve në regjimin e posaçëm

1. Pranimi i të dënuarve/paraburgosurve në Regjim të Posaçëm, do të bëhet sipas kërkesave të nenit 17 të Ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar, neni 30 dhe Kreut të III, të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, të miratuar me VKM Nr.209, datë 06.04.2022.
2. Dosja personale e të dënuarit/paraburgosurit, që do të pranohet në Regjimin e Posaçëm, duhet të ketë detyrimisht Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë, për vendosjen në Regjimin e Posaçëm. Verifikimi i plotë i dokumentacionit, bëhet nga juristi i IEVP.
3. Komisioni i Pranimit, e informon të burgosurit për urdhrin e Ministrit të Drejtësisë, duke mbajtur proces verbal njohje.

Neni 20

Informimi i të dënuarit/paraburgosurit lidhur me regjimin e posaçëm, të drejtat dhe detyrimet

I dënuari/paraburgosuri, që pranohet në Regjimin e Posaçëm të sigurisë së lartë, informohet nga Komisioni i Pranimit, për të drejtat e tij, sipas parashikimit të nenit 17 të Ligjit nr. 81/2020, për:

- Vizitat me familjarët
- Sendet personale të lejuara
- Komunikimi në telefon me familjen
- Kontrollin e korrespondencës
- Kërkesat dhe ankesat
- Orarin e veprimeve
- Kohën e ajrimit
- Dietën ushqimore
- Vizitat shëndetësore
- Takimet me avokatin
- Të drejtën e animimit sipas ligjit
- Procedurën disiplinore
- Përfitimet që mund të ketë nga sjelljet pozitive dhe problemet që mund të krijohen nga sjellje dhe qëndrime negative.

Neni 21

Vlerësimi fillestar i nevojave dhe faktorëve të riskut për sistemimin në dhomë

1. Me qëllim parandalimin e rrezikut për jetën dhe të cenimit të sigurisë, stafi i burgut bën një vlerësim të riskut, bazuar në të dhëna lidhur me histori kriminale, histori dhune, (vrasje, plagosje, peng marrje, zjarrvënës, sulme të stafit dhe të të tjerëve, sulme për motive raciale, radikale, homofobi, politike etj, në institucione ku ka vuajtur dënimin e mëparshëm), probleme të rënda të shëndetit mendor, varësi aktuale nga droga.
2. Vlerësimi i riskut për akomodimin në qeli, hartohet sipas një formati tip, i cili hartohet bazuar në vëzhgimin e sjelljes, intervistën, dokumentacionin e dosjes personale dhe informacione të përftuara nga agjenci të sigurisë.

Neni 22

Pajisjet e dhomës, higjiena dhe sendet personale të dënuarve/paraburgosurve

1. Të dënuarit/paraburgosurit, në Regjim të Posaçëm, sistemohen në dhoma për një person.
2. Dhoma e banimit në Regjimin e Posaçëm, duhet të ketë sipërfaqe jo më pak se 6m² dhe kubaturë 9m³.
3. Ndriçimi, drita artificiale, ngrohja, do të jenë sipas kërkesave të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.
4. Pajisjet e dhomës janë një krevat i fiksuar, dyshek, batanije, çarçaf. Një tavolinë dhe një karrige të fiksuara, një televizor me kanale të reduktuara edukative dhe kohë të kufizuar, të fiksuara dhe mbuluar me xham. Në banja do të ketë një "ëc", një lavaman dhe një rubinet, të cilët shkarkojnë jo më shumë se 150 litra ujë në ditë dhe një pasqyrë të fiksuar në mur.
5. Çelësi i dritave të komandohet nga jashtë dhomës. Llamba e ndriçimit do të jetë me zgarë dhe e paarritshme nga i dënuari/i paraburgosuri.
6. Brenda në dhomë vendoset një zile për të njoftuar punonjësit në rast nevojë.
7. Pajisjet e pastrimit, kovë, leckë dhe fshesë mbahen në dhomën e banimit, ndërsa detergjentet për larjen dhe pastrimin jepen nga punonjësit e policisë kur është e nevojshme dhe nxirren jashtë dhomë me përfundimin e pastrimit.
8. I dënuari/paraburgosuri pajiset me uniformë, sipas stinës, ku përfshihen të brendshme, pantallona, xhakëtë, triko, këmbishë, këpucë, peshqir.
9. Të dënuarit/paraburgosurit i lejohet të mbajë në dhomën e tij këto sende personale:
 - a. Pastë dhe furçë për larje dhëmbësh.
 - b. Pajisje tualeti, brisk rroje, sapun rroje.
 - c. Libra me karakter edukativ, të cilët nxirren jashtë dhomës pas leximit.
 - d. Letër dhe mjet shkrimi, të cilat i jepen të dënuarit/paraburgosurit në rast se i kërkon dhe nxirren jashtë pas përfundimit të letrës.

Neni 23

Ushqimi

1. Të dënuarit/paraburgosurit, nuk i lejohet të marrë nga familjarët, ushqime, pije, fruta, ëmbëlsira.
2. Të dënuarit/paraburgosurit i garantohet ushqim nga institucioni në tre vakte, sipas orarit të veprimeve.
3. Ushqimi para se të shpërndahet, kontrollohet nga specialisti i informacionit dhe ndihmësmjeku, duke u dokumentuar procesi dhe duke ruajtur kampionët.
4. Shpërndarja e ushqimit në të tre vaktet do të bëhet nga kuzhinieri, i shoqëruar nga jo më pak se dy punonjës të sigurisë.
5. Shpërndarja e ushqimit do të bëhet me pajisje të institucionit. Pas konsumit të vaktit, pajisjet (lugë, pjata) dalin jashtë dhomë dhe merren nga kuzhinieri.
6. I dënuari ka të drejtë të blejë nga operatori ekonomik i kontraktuar, ujë, bulmet të pakeluar, sallameri, biskota, ccokollata, fruta, lëngje, duhan, pajisje të higjienës personale (pastë dhe furccë dhëmbësh, brisk, shkumë dhe krem rroje, në vlerë jo më shumë se 8000 (tetë mijë) lekë/muaj.

Neni 24

Ajrosja

1. Koha e ajrimit, do të jetë sipas nenit 17 të Ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”,
2. Të dënuarit/paraburgosurit, e kryejnë ajrimin më vete, ose në grupe shoqërimi të vlerësuara nga personeli i IEVP.
3. Orari i ajrosjes do të jetë nga ora 08:00 deri në orën 16.00 gjatë verës dhe nga ora 08-14:00, gjatë stinës së dimrit.
4. Nxjerrja e të dënuarit/paraburgosurit në ajrim, bëhet me prezencën e tre punonjësve të sigurisë, gjithnjë duke kryer kontroll trupor, me prekje dhe detektor, në dalje dhe në hyrje.
5. Gjatë kryerjes së ajrimit, të dënuarit/paraburgosurit, krahas mbikëqyrjes me kamera, mbikëqyrën herë pas here, nga jo më pak se dy punonjës të sigurisë.

Neni 25

Vizitat me familjen e të burgosurve të regjimit të posaçëm

1. Të dënuarit/paraburgosurit kanë të drejtë të kenë një vizitë në muaj, deri në 30 minuta, me familjen e tij. Anëtarët e familjes, që kanë të drejtë të bëjnë takim janë sipas përcaktimit të Ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
2. I dënuari, mund të kryejë takim me persona të tjerë, pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm, mbi bazën e kërkesës me shkrim të të dënuarit, ose avokatit të tij drejtuar Drejtorit të Institucionit. Drejtori i Institucionit, pasi vlerëson faktet, i propozon Drejtorit të Përgjithshëm.
3. I paraburgosuri, mund të kryejë takim me persona të tjerë, pas miratimit nga Prokurori, mbi bazën e kërkesës me shkrim të paraburgosurit, ose avokatit të tij drejtuar Drejtorit të Institucionit. Drejtori i Institucionit, pasi vlerëson faktet, i propozon Prokurorit.
4. I dënuari/paraburgosuri, duhet të deklarojë gjatë pranimin, në regjimin e posaçëm, emrat e anëtarëve të familjes, me të cilët dëshiron të ketë takim.
5. Në takim nuk mund të jenë më shumë se tre persona.
6. Vizitorët nuk lejohet të sjellin për të dënuarin/paraburgosurin sende, apo ushqime të asnjë lloji kategorie.
7. Takimi bëhet në dhomë të ndarë me xham, duke komunikuar me citofon, pa mundësi kontakti.
8. Takimi është i mbikëqyrur me kamera dhe regjistrim audio.
9. Vizita duhet të bëhet me rezervim, të paktën një ditë përpara.
10. Shefi i Policisë, vihet në dijeni një ditë përpara për vizitën e planifikuar.
11. Shefi i Policisë, merr masat e kontrollit dhe të sigurisë të familjarëve të dënuarit/paraburgosurve.
12. I dënuari/paraburgosuri, para daljes për vizitë dhe pas kthimit, kontrollohet në prani të tre punonjësve të sigurisë.
13. Të gjitha vizitat dokumentohen në një regjistër tip, ku shënohen të dhëna të dënuarit/paraburgosurit, data dhe ora e takimit, të dhënat e personave me të cilët takohet dhe lidhja familjare që kanë.
14. Lidhja familjare e të dënuarit/paraburgosurit, duhet të vërtetohet me dokumente ligjore, të cilët verifikohen paraprakisht për vërtetësinë e tyre.

Neni 26

Komunikimi me telefon

1. Të dënuarit/paraburgosurit, kanë të drejtë të kryejnë një telefonatë në muaj me familjen, me kohëzgjatje jo më shumë se 10 minuta.
2. I dënuari/paraburgosuri, duhet të deklarojë numrat e telefonit, të anëtarëve të familjes, me të cilët dëshiron të komunikojë.
3. Biseda telefonike regjistrohet.
4. Me qëllim informimin e të dënuarit/paraburgosurit, mbi kartofon, vihet shënimi “Kjo bisedë dëgjohet”
5. I dënuari/paraburgosuri, bën kërkesë tek Drejtori i institucionit, me anë të një formati tip, për të kryer bisedat telefonike, ku përcakton numrin e telefonit si dhe personin me të cilin do të komunikojë.
6. Drejtori i Institucionit, pasi verifikon faktet, i drejtohet Drejtorit të Përgjithshëm, për miratimin e telefonatës, nëqoftëse personi është i dënuar.
7. Drejtori, pasi verifikon faktet, i drejtohet prokurorisë, për miratimin e telefonatës, nëqoftëse personi është i paraburgosur.
8. Shefi i policisë, pasi merr vendimin e Drejtorit, për lejimin e telefonatës nga i dënuari ose urdhrin e prokurorit për të paraburgosurin, shkon në Sektorin e Regjimit të Posaçëm dhe menaxhon daljen e të dënuarit/paraburgosurit për të komunikuar me telefon.
9. Kartofoni duhet të jetë i montuar në një distancë që nuk mund të arrihet nga i dënuari/paraburgosuri.
10. Numrin e kërkuar nga i dënuari/paraburgosuri dhe të aprovuar nga drejtori, ose prokurori, e formon punonjësi i policisë, që është në detyrë dhe që është i ngarkuar në libër të shërbimit me këtë detyrë.
11. Shërbimi i Sigurisë, mban regjistër tip, për regjistrimin e të gjitha telefonatave, ku shënohen të dhënat e të dënuarit/paraburgosurit, data dhe ora e komunikimit, numrin e telefonit dhe emrin e personit, me të cilin komunikon.

Neni 27

Komunikimi me Avokatin e Popullit

I dënuari/paraburgosuri, mund të komunikojë me Avokatin e Popullit në telefon, bazuar në procedurat që përshkruhen në nenin 17 të Ligjit nr. 81/2020, duke mos patur kufizime dhe pa u dëgjuar biseda.

Neni 28

Takimet me Avokatin mbrojtës

Takimet me avokatin mbrojtës kryhen brenda orarit zyrtar të punës, përveç rasteve veçanta. Kërkesa për raste të veçanta miratohet nga drejtori i institucionit. Koha e takimit me avokatin mbrojtës kufizohet në varësi të kushteve konkrete të institucionit dhe aktiviteteve të programuara. Gjatë takimeve me të mbrojturit e tyre, avokatët nuk lejohet tu japin atyre sende, ushqime, pajisje, dhurata etj.

Neni 29

Menaxhimi i sigurisë

1. Në regjimin e posaçëm, të gjitha dyert e dhomave mbahen të mbyllura. Për çdo veprim që do të kryhet, dalje në ajrim, marrje ushqimi ose medikamentesh, dalje për telefon, ose për takim, gjithmonë veprohet vetëm me një derë.
2. Të gjitha veprimet me të dënuarin/paraburgosurin kryhen në praninë e dy, ose më shumë punonjës të policisë, sipas vlerësimit të rrezikshmërisë dhe nivelit të bashkëpunimit.
3. Në asnjë rast dhe rrethanë nuk lejohet që një punonjës i vetëm, çfarëdo pozicioni e specialiteti, të takojë i vetëm një të dënuar/paraburgosur të regjimit të posaçëm.

4. Në hyrje të regjimit të posaçëm, mbahet regjistër, ku dokumentohet çdo veprim, si dhe gjithë aktiviteti që kryhet në sektor.
5. Gjatë shërbimit 24 orë, të bëhen minimalisht 5 numërime të rregullta duke parë fizikisht të dënuarin/paraburgosurin.
6. Të gjitha lëvizjet e të burgosurve duhet të menaxhohen dhe komunikohen me anë të telefonit, ose radiove të burgut.
7. Të burgosurit duhet t'i nënshtrohen kontrollit me duar gjatë çdo lëvizjeje kur dalin apo hyjnë në sektorin e akomodimit.
8. Kontrollat me duar të plotësohen me kontrole me anë të pajisjeve teknike sipas nevojës.
9. Të gjitha qelitë duhet t'i nënshtrohen kontrollit të elementëve fizik çdo ditë. Mbahen shënime lidhur me to, dhe kontrolli duhet të drejtohet nga punonjësi i nivelit të mesëm të ngarkuar me regjimin e posaçëm.
10. Të burgosurit duhet të mbikëqyren gjithmonë kur janë jashtë dhomave.
11. Si rregull do të mbahet vetëm një i burgosur në një dhomë.
12. Vendosja në dhomë dhe në mjediset e aktiviteteve duhet të bëhet pas vlerësimit të riskut dhe të jetë e lidhur me informacionin kriminal.
13. Të gjitha dhomat të kontrollohen në mënyrë të imtësishme të paktën një herë në javë.
14. Në rastet e nevojave për shoqërim jashtë institucionit, për arsye shëndetësore, hetimore, gjyqësore etj., në të gjitha rastet vlerësohet nëse ka një alternativë tjetër, pra që mund të jepet mjekim brenda institucionit, pa cënuar standardin, mund të përdoret video konferencë etj.
15. Procedurat e transportit, bazohen në udhëzimin përkatës dhe vlerësimin e riskut, të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm.
16. Gjatë gjithë lëvizjeve jashtë institucionit, p.sh. për në spitalet jashtë, të burgosurit duhet të jenë të lidhur me dy palë pranga.

Neni 30

Regjimi i mbikëqyrjes së veçantë

1. Regjimi i mbikëqyrjes së veçantë organizohet sipas nenit 68-69 të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
2. I burgosuri i vendosur në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë nuk i lejohej të mbajë televizor, frigorifer, çakmak, petrogas, bombula, dhe sende të tjera që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e të burgosurve.
3. I burgosuri i vendosur në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë mund të kryejë 2 (dy) telefonata në javë nga 10 minuta me antarë të familjes, sipas parashikimeve në këtë rregullore për komunikimin në telefon.
4. I burgosuri i vendosur në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë i lejohej të blejë tek Operatori Ekonomik artikuj të parashikuar dhe lejuar, në vlerë jo më shumë se 8000 (tetë mijë) lekë në muaj.

Neni 31

Vendosja e personave me status “bashkëpunëtorë të drejtësisë”

1. Të dënuarit dhe paraburgosurit, që kanë fituar statusin e Bashkëpunëtorit të Drejtësisë, do të vendosen në sektorë të veçantë të miratuar.
2. Drejtoria e Institucionit në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë së Shtetit, marrin masa për sigurimin e jetës së personit dhe realizimin e programit të trajtimit individual të tij.

3. Vendosja e të burgosurve me statusin e bashkëpunëtorëve të drejtësisë bëhet në dhoma të ndara nga njëri-tjetri duke ruajtur konfidencialitetin e plotë dhe fshehtësinë ndaj çdo të burgosuri, përveç rasteve kur miratohet nga ana e prokurorëve përkatës “SPAK” ose Drejtuesit të Prokurorisë për lejimin e kontaktit fizik me bashkëvuajtësit e tjerë në dhomat e banimit të tyre.
4. Ajrimi i të burgosurve bashkëpunëtorë të drejtësisë bëhet tek e tek secili në bokset e veta të ajrimit dhe mbikëqyret nga punonjësit e grupit të sigurisë së IEVP-së, përveç rasteve kur jepet miratimi nga prokurori i çështjes për ajrimin në grup të tyre.
5. Takimi me familjarët do të kryhet në dhomën e caktuar e cila është e mbikëqyrtur me kamera përveç rasteve kur jepet miratim nga prokurori për të zhvilluar takim në dhomë.
6. Ushqimi shpërndahet nga kuzhinierët e institucionit dhe kampionët e ushqimeve për këta të burgosur mbahen të veçanta nga kampionët e tjera të mbyllura me çelës dhe në kushte frigoriferike dhe shoqërimi i kuzhinierit bëhet me punonjës të grupit të sigurisë.
7. Pajisjet e dhomave janë të njëjta me të burgosurve të kategorive të tjera. Mund të bëhet një përjashtim nëse kërkohet në mënyrë të argumentuar nga prokurori i çështjes në funksion të bashkëpunimit, por pa rrezikuar rendin dhe sigurinë.

KAPITULLI IV

PRANIMI DHE VENDOSJA E TË DËNUARVE DHE TË PARABURGOSURVE NË IEVP

Neni 32

Pranimi

1. Pranimi i të dënuarve dhe paraburgosurve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale bëhet sipas parashikimeve të nenit 38, Ligji Nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” dhe kreut III, të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të miratuar me VKM Nr.209 datë 6.4.2022.
2. Në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale pranohet vetëm personi për të cilin gjykata kompetente ka nxjerr aktvendim për caktimin e masës arrest në burg, ose dënim me burgim, bazuar në dokumentacionin e parashikuar në nenin 10 dhe 11 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.
3. Pranimi i të burgosurve kryhet brenda orarit zyrtar të punës, nga ora 08:00 deri në orën 16:30. Përjashtimet nga ky rregull mund të lejohen me konfirmim të Drejtorit të IEVP.
4. Pasi sektori ligjor konfirmon dokumentacionin shoqëruar të të burgosurit në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve kryhen veprimet për pranimin e tij.
5. I burgosuri në momentin e pranimit pajiset me rroba të pastra për fjetje dhe vendoset në ambiente të observimit deri në 10 ditë.
6. Staf i informon të burgosurin për të drejtën e tij për të njoftuar familjen me telefon për vendndodhjen. Nëqoftëse i burgosuri nuk i disponon mjete për të komunikuar me familjen, këtë ja mundëson institucioni.
7. Drejtoria e IEVP cakton një punonjës si person kontakti për të burgosurin, i cili ndjek kërkesat etj, lidhur me takimet me familjen dhe të afërmit, numrat e telefonit me të cilët do të komunikojë, aspekte të sigurisë, probleme të marrëdhënieve me të burgosurit etj, i cili koordinon me specialistët e shërbimeve përkatëse.
8. Gjatë procedurës së pranimit, një nga punonjësit e sektorit ligjor bën fotografimin e të burgosurit në tri profile, mat peshën fizike dhe gjatësinë, shënojnë të dhënat personale, shenjat e veçantë, tatuazhet

dhe shenjat e tjera nëse i ka duke përfshirë dëmtime, të cilat mbahen në një format tip që administrohet në dosjen e tij. Fotografimi i të burgosurve duhet të kryhet edhe gjatë kryerjes së dënimit, jo më pak se një herë në tre vite.

9. Në rast se gjatë pranimi të të burgosurit, konstatohen shenja dhune, dëmtime trupore, ose i burgosuri referon shqetësime shëndetësore do të hartohet një procesverbal nga personeli shëndetësor, ku të pasqyrohen të gjitha shenjat ose dëmtimet e konstatuara. Në procesverbal do të nënshkruajnë anëtarët e komisionit të pritjes dhe përgjegjësi i patrullës dhe shoqërimit. Procesverbali do të mbahet në tre kopje, një kopje do të vendosen në dosje, një kopje do të qëndroj tek libri i komisionit të pritjes si dhe një kopje tjetër do ti jepet përgjegjësit të grupit të shoqërimit. Për të gjithë problematikën e konstatuar në drejtim të shenjave të dhunës do të njoftohen organet e procedimit penal, për kryerjen e veprimeve proceduriale dhe Drejtori i Institucionit.
10. I burgosuri që pranohet në institucion menjëherë ekzaminohet nga mjeku i institucionit dhe në rast se është e nevojshme, merren masa për të dërguar të burgosurin për vizitë të specializuar.
11. Nëse pranimi i personit të burgosur bëhet pas kohës së rregullt të punës, ai vendoset në dhomën e veçantë deri në ditën vijuese të punës, kur do të kryhen veprime të nevojshme të parashikuara në këtë nen.

Neni 33

Parandalimi i dhunës dhe trajtimi i viktimave

1. Të burgosurve që kanë pasur përvoja të dhunës fizike, psikologjike ose seksuale, para ose gjatë qëndrimit në institucion, u ofrohen menjëherë masa mbrojtjeje, mbështetje dhe këshillime ligjore me qëllim rehabilitimin e tyre.
2. Administrata e IEVP-së bën përpjekje për të mbrojtur të burgosurit e rrezikuar nga kërcënimet dhe keqtrajtimet nga ana e të burgosurve të tjerë.
3. Në rastet e ushtrimit të dhunës, autoritetet e institucionit, në çdo rast, nisin hetim të pavarur, nga strukturat dhe organet kompetente të ngarkuara me ligj, duke respektuar parimin e privatësisë, të mbrojtjes dhe sigurisë personale.

Neni 34

Verifikimi i identitetit

1. Gjatë pranimi të personit të dënuar ose të paraburgosur në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, vërtetohet identiteti i tij në bazë të dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, kartë identiteti, pasaportë biometrike ose çdo dokument informacioni lidhur me identitetin).
2. Nëse i paraburgosuri/dënuari nuk ka asnjë dokument identifikimi në bazë të cilit mund të vërtetohet identiteti i tij atëherë përgjegjësi i grupit të shoqërimit duhet të ketë siguruar një dokument provizor identifikimi i cili përmban të dhënat të cilat duhet të jenë në përputhje me të dhënat e vendimit të gjykatës kompetente. Menjëherë pas pranimi, sa më shpejtë të bëhet verifikimi identiteti përmes zyrës së gjendjes civile dhe strukturave të Policisë së Shtetit.
3. Dokumentet në bazë të cilave është vërtetuar identiteti i personit të burgosur, do të ruhet në dosjen e tij.
4. Nëqoftëse i burgosuri është pranuar në IEVP pa kartën e identitetit, merren masa për ta pajisur për një periudhë jo më vonë se tre muaj, ndërsa numri personal duhet të kërkohet menjëherë nga Drejtoria e Gjendjes Civile, për arsye të hedhjes së të dhënave në sistem.

5. Sektori Ligjor i IEVP, jo më vonë se 48 orë pas pranimit të të burgosurit me masë sigurie arrest në burg ose i dënuar me burgim, i dërgon të dhënat në zyrën e gjendjes civile rajonale për regjistrimin e shtetasit.

Neni 35

Regjistrimi i të dhënave

1. Sektori Ligjor kryen regjistrimin e të burgosurit sipas gjeneraliteteve përkatëse, emri, atësi, mëmësi dhe mbiemrin e personit të dënuar ose të paraburgosur, nr. ID, datëlindje, vendlindje, vendbanim, gjinia, shtetësi, dita dhe ora e pranimit, vepra penale për të cilën është dënuar ose dyshohet, masën e dënimit, Nr vendimit dhe data, gjykata që ka dhënë vendimin, etj.
2. Këto të dhëna dhe të tjera hidhen në Regjistrin themeltar, në evidencat dhe në sistemin MISP. Gjithashtu kryhet regjistrimi i të burgosurit edhe në sistemin e menaxhimit të hyrje daljeve dhe vizitave.

Neni 36

Kontrolli gjatë pranimit

1. Pas vërtetimit të identitetit, nga punonjësi i pranimit, kryhet kontrollimi i personit të burgosur dhe të sendeve të tija personale. Nëse ekziston dyshimi i bazuar që personi i burgosur posedon mjete të pa lejuara duhet të bëhet edhe kontrollimi i hapjeve trupore të personit të burgosur dhe atë e kryen personeli shëndetësor me kërkesën e drejtorit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale.
2. Kontrolli trupor dhe i sendeve personale të të burgosurit kryhet sipas procedurave përkatëse. Sendet të cilat nuk lejohen të futen në ambientet e banimit, ruhen provizorisht me procesverbal të nënshkruar nga i burgosuri edhe nga kontrolluesit për një periudhë jo më shumë se 2 mujore, brenda së cilës duhet të tërhiqen nga familjarët ose personat e autorizuar nga i burgosuri.
3. Të burgosurit lejohen të kenë sende personale, të parashikuara nga kjo rregullore, të cilat pakëtohen në një çantë me dimensione jo më të mëdha se (70 cm x 55 cm x 25 cm dhe ka një peshë maksimale prej 15 kg për kuti). Në këtë vëllim nuk futen pajisjet elektroshtëpiake si ftohës, apo televizor.
4. Kontrolli personal duhet të bëhet vetëm nga punonjës policie të së njëjtës gjini me të burgosurin.
5. Kontrolli i të burgosurit bëhet duke respektuar personalitetin dhe dinjitetin e tij.
6. Në përfundim të kontrollit, mbahet një procesverbal në format tip, ku shënohen sendet e lejuara të futen brenda në ambientet e banimit dhe sendet të cilat mbahen provizorisht në ruajtje deri në plotësimin e afatit të kthimit. Procesverbali nënshkruhet nga dy kontrollorët dhe i burgosuri dhe një kopje futet në dosjen personale dhe kopja tjetër i jepet të burgosurit.

Neni 37

Sendet të cilat i lejohen personit të dënuar ose të paraburgosur

1. Të burgosurit mund të mbajnë sendet e mëposhtme:
 - a. dokumentet ligjore;
 - b. pajisjet e përshkruara mjekësore;
 - c. një sapun;
 - d. një bic për rroje;
 - e. një paste dhe një furçë rroje
 - f. një shishe plastike shampo;
 - g. një pastë dhe furçë për dhëmbë;

- h. një krehër
 - i. sende të blera sipas listës tek operatori ekonomik i kontraktuar;
 - j. një album me 10 fotografi familjare (pa kornizë);
 - k. një radio - kasetofon –CD për dhomë (pa mundësi /regjistrimi/incizimi), përfshirë edhe bateritë për radio;
 - l. një mp3 –mp4 player (pa mundësi incizimi për të dënuarit)
 - m. pajisje për të shkruar (një laps dhe një fletore)
 - n. librat dhe fletore shkollë të aprovuara;
 - o. një shkrepës;
 - p. dy paketa cigare;
 - q. një palë letra për lojë, shah, domino,
 - r. tri materiale leximi (libra, materiale religjioze);
 - s. gazeta, revista.
 - t. ushqim të cilin të burgosurit e dënuar e blejnë tek operatori ekonomik i kontraktuar.
2. Sende me vlerë të lejuara për të dënuarit dhe paraburgosurit:
- a. një orë dore;
 - b. një unazë;
 - c. një zinxhir dore ose qafe;
 - d. një vath për vesh;
 - e. një palë syze dielli.
3. Veshmbathje:
- a. një xhaketë/ose xhup/xhuboks;
 - b. katër këmisha / nën-këmisha;
 - c. katër palë ndërresa të brendshme;
 - d. një palë këpucë/atlete (pa lidhës për të paraburgosurit);
 - e. një pale mbathje sportive (pa lidhës për te paraburgosur);
 - f. dy triko
 - g. një palë sandale
 - h. dy palë pantallona;
 - i. pesë palë çorape;
 - j. dy palë rroba sportive.
 - k. dy pale pizhame
 - l. një palë dorëza (të leshit për të dënuarit)
 - m. një kapele në sezonin e dimrit (për të dënuarit).
 - n. Veshmbathjet me ngjyra të uniformës së policisë së burgjeve nuk do lejohen.
4. Sendet e pranuar nga institucioni
- a. Dy çarçafë;
 - b. Dy batanije;
 - c. Një jastëk dhe një këllëf jastëku;
 - d. Dy peshqirë (një i vogël dhe një i madh);
 - e. Një uniformë;
 - f. Një jelek për të dënuarit;
 - g. Gotë për ujë (plastike);
 - h. Pjatë për ngrënie (plastike);

- i. Lugë plastike.
5. Për të burgosurit që punojnë:
 - a. Një uniformë pune;
 - b. Një palë këpucë pune.
6. Paratë nuk lejohen të mbahen nga i burgosuri. Paratë duhet të depozitohen në llogarinë personale në emër të tij, përveç nëse ai vendos që në momentin e pranimit që paratë ti kthehen familjes.
7. Sende të lejuara në një (1) dhomë:
 - a. një (1) TV deri në 32 pol, i cili nuk lidhet me internet.
 - b. një (1) frigorifer për dy deri në katër persona me kapacitet jo më të lartë se 250 l
 - c. një (1) ftohës dhe ngrohës, në rast se institucioni nuk ka instalime ngrohje ftohje 1500-2000Ë, me kursim energjie jo më pak se A++.
 - d. një (1) pllakë gatimi me diametër 20cm,
 - e. një ekspres kafeje familjarë
 - f. një tavolinë plastike dhe karrige plastike sipas numrit të të burgosurve në dhomë.
 - g. sendet të cilat kanë drejtë ti blejnë përmes operatorit ekonomik.
8. Në regjimin e banimit të të burgosurve, nuk lejohet të futet asnjë send, ose pajisje, e cila është e ndërtuar në mënyrë të tillë, që nuk mund të hapet për t'u kontrolluar në brendësi të saj.
9. Për sendet e çmuara si orë dore, varse, apo unaza, sektori i sigurisë, mban regjistër të detajuar me të dhënat e markës së sendeve, datën e hyrjes në regjim dhe të dhënat e personit që e ka në pronësi. (me sende të çmuara kuptohen ato sende që kanë vlerë të lartë, 200 euro).

Neni 38

Mjetet e punës që futen në ambientet e banimit të të burgosurve

1. Mjetet e punës, si pinca, kaçavidë, çekiç, mjet prerës, trapan etj, si dhe lëndët e përdorura, (gozhdë, bullona, elektroda, shufra hekuri, llamarinë, lëndë drusore, mermer, gurë etj) mund të futen në regjim të brendshëm, vetëm kur është e domosdoshme, bazuar në një urdhër të drejtorit të institucionit dhe të një plani me detyra dhe përgjegjësi të detajuara për arsye të domosdoshme.
2. Kur mjetet e punës dhe lëndët që do të përdoren, urdhërohet të futen në regjimin e brendshëm, ato inventarizohen në një rregjistër tip, duke përshkruar emërtimin, sasinë dhe të dhëna të tjera të nevojshme. Kontrollohen sipas procedurave dhe më pas i dorëzohen me procesverbal personit të ngarkuar për përdorimin e tyre dhe punonjësit të sigurisë.
3. Kur përfundon detyra, mjetet e punës dhe lëndët e futura në regjim të brendshëm, dalin jashtë duke u kontrolluar dhe inventarizuar sipas procesverbalit të dorëzimit.
4. Mjetet e punës mbahen në ambiente të sigurta, jashtë regjimit të brendshëm, të inventarizuara, të emërtuara dhe klasifikuara sipas rrezikut që kanë.
5. Procedura e kontrollit, marrjes dhe dorëzimit të mjeteve të punës, zbatohet e njëjtë edhe për mjetet dhe lëndët që përdorin të dënuarit dhe paraburgosurit në punë dore ose punë artizanale.
6. Kur një mjet pune humbet, shefi i sigurisë organizon kontroll të plotë deri në gjetjen e tyre.

Neni 39

Pajisjet e palestrave

1. Të gjitha mjetet e forcës që ndodhen në ambientet e zhvillimit të aktiviteteve sportive (palestra), listohen, në një rregjistër si inventar i elementeve të sigurisë, kontrollohet gjendja fizike e mjeteve të forcës sipas inventarit përkatës.

2. Hyrja dhe dalja e të dënuarëve ose e të paraburgosurve në këto ambiente, të bëhet pas kontrollit fizik.
3. Aktiviteti në sallat sportive të mbikqyren nga punonjësit e policisë të rolit bazë ose punonjësit e sektorit të kujdesit social.

Neni 40

Vendosja e të dënuarve në IEVP

1. Përcaktimi i IEVP për vendosjen e të burgosurve, ose rishpërndarjen e tyre, është pjesë e procesit të ndarjes dhe klasifikimit (të dënuar të paraburgosur, femra, meshkuj, të mitur, të rritur, niveli sigurisë, grupe të strukturuar kriminale, vepra terroriste etj). Vendosja e të burgosurve, zakonisht i referohet IEVP, por në raste të veçanta ajo përfshin edhe njësinë (seksionin) specifik, brenda IEVP.
 - a. Vendosja fillestare e të dënuarit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në konsultim me Prokurorin³.
 - b. Rishpërndarja e të dënuarve në IEVP, apo seksione, bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bazë të rekomandimit nga Drejtoria e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, e cila shqyrton procesin për vendosje, apo rishpërndaje të të burgosurve.
 - c. Drejtoria e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në DPB gjatë procesit të vlerësimit të procedurës për vendosjen, apo transferimin e të dënuarit konsultohet me Drejtorinë e Çështjeve Shoqërore, Drejtorinë e Policisë, Sektorin e Shëndetësisë, Drejtorinë e IEVP ku është i akomoduar dhe Drejtorinë e IEVP, ku parashikohet të akomodohet i dënuari.
2. Gjatë marrjes së vendimit për vendosjen ose rivendosjen e të burgosurve në IEVP, merren në konsideratë këto të dhëna:
 - a. Niveli i sigurisë, përfshi edhe kohëzgjatjen gjatësinë e dënimit dhe veprën penale
 - b. Identifikimi i riskut për përsëritje të krimit, arratisje dhe rrezikun për komunitetin në rast arratisje.
 - c. Risku që ka i dënuari ndaj të tjerëve dhe për vetveten.⁴
 - d. Afërsia me vendbanimin
 - e. Përdorimi i drogës dhe alkoolit dhe nevoja për trajtim.
 - f. Historiku i qëndrimeve dhe sjelljeve në burgje
 - g. Probleme shëndetësore ose psikiatrike.
 - h. Ndonjë kufizim ose paaftësi fizike,
 - i. Probleme lidhur me familjen
 - j. Nevoja tranzitore (hetime, probleme mbipopullimi, pjesëmarrje në programe trajnimi profesional, arsye ekstradimi, cilësia si bashkëpunëtor e dëshmitar i drejtësisë, grupe ose individ të dënuar për vepra terroriste.
 - k. Faktorë të tjerë të menaxhimit të burgjeve, sigurisë dhe rendit.
 - l. Infrastrukturën e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale. Nivelin e sigurisë, gjendjen e elementëve të sigurisë, kushtet e trajtimit në përputhje me standardet.
 - m. Shqyrtimi i kërkesës për transferim bëhet në përputhje me nenin 107 të Rregullores së Përgjithshme, duke administruar dhe vlerësuar dokumentacionin e parashikuar në pikën 2;3;4;5 të këtij neni.

Neni 41

Vendosja e të paraburgosurve

³ Ligji Nr.79/2020, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", neni 23, pika 4 dhe Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, miratuar me VKM Nr.209, datë 6.4.2022, neni 11.

⁴ Staf i duhet të bëjë vlerësimin e riskut për ndarje brenda seksionit dhe në dhomë.

1. Të paraburgosurit, vendosen në I EVP, sipas juridiksionit të rrethit gjyqësor.
2. I EVP që janë paraburgime, ose kanë seksion paraburgimi pranojnë të paraburgosurit sipas juridiksionit territorial që mbulojnë. Policia e Shtetit shoqëron të paraburgosurin me dokumentacionin përkatës parashikuar në VKM Nr.209, datë 06.04.2022, neni 10⁵.
3. Kërkesa/njoftimi nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit, mbi pranimin e shtetasve me statusin e të paraburgosurit, i drejtohet I EVP, sipas juridiksionit, me shkresë zyrtare, ose me e-maili në adresën zyrtare që disponon I EVP-ja.
4. Sektori ligjor pranë I EVP-së, vlerëson dokumentacionin e përcjellë nga strukturat e Policisë së Shtetit, dhe nëse është në përputhje me nenin 10 të VKM Nr. 209 datë 06.04.2022 "Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve" i konfirmon strukturave të Policisë së Shtetit pranimin e të paraburgosurit.
5. Përgjithimisht nga rregulli i përgjithshëm, i paraburgosuri/ i dënuari mund të vendoset në një institucion të ekzekutimit të vendimit penal jashtë juridiksionit, në rastet kur:
 - a. Nuk ka kapacitete të lira, për arsye mbipopullimi
 - b. Është në rikonstruktion, apo në situatë emergjente
 - c. Ka të dhëna bindëse për konflikte ku është i përfshirë i paraburgosuri
 - d. I paraburgosuri ka cilësinë e bashkëpunëtorit dhe dëshmitarit të drejtësisë
 - e. I paraburgosuri është arrestuar për qëllime ekstradimi
 - f. I paraburgosuri është pjesë e një grupi të strukturuar kriminal, bandë e armatosur ose terroriste.
6. Sektori Ligjor i I EVP, ja përcjell menjëherë dosjen Drejtorisë së Ekzekutimit të Vendimeve Penale, e cila në konsultim me Drejtorinë e Policisë Burgjeve, përcakton I EVP, ku do të vendoset i paraburgosuri dhe menjëherë ja konfirmon strukturave të Policisë së Shtetit.
7. Në rastet kur personi me masë sigurie "arrest në burg", ndodhet i shtruar në spital, apo ka nevojë për trajtim shëndetësor, merret nga I EVP në juridiksion të Rrethit Gjyqësor, ndërsa ruajtja e tij koordinohet me Drejtorinë e Policisë së Burgjeve, sipas territorit.
8. Nëqoftëse personi i ndaluar nga strukturat e Policisë së Shtetit, është i dënuar, procedura e vendosjes së tij në I EVP do të bëhet nga Drejtoria e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, sipas kriterëve të nenit 40 të kësaj rregulloreje.

Neni 43

Vendosja e të dënuarve pas marrjes së dënimit me formë të prerë

1. Pas marrjes së vendimit të formës së prerë, Drejtoria e I EVP-ve dërgon në DPB, praktikën për transferimin e të burgosurit (*Kërkesa me shkrim e Drejtorisë së I EVP-së shoqëruar me Urdhër ekzekutimi të prokurorit, vlerësim të riskut dhe nevojave të të burgosurit, si dhe relacion sipas arsyeve të transferimit të parashikuara në nenin 107, pika 2;3;4;5*). Përpara se të dërgohet praktika në DPB, verifikohet se a janë përfunduar të gjitha vlerësimet, a është përcaktuar niveli i sigurisë. (*siguri e lartë, niveli bazë, standard, apo i zgjeruar, ose siguri e zakonshme, siguri e ulët*).

⁵ Neni 10 i VKM Nr.209, datë 6.4.2022; Pranimi bëhet mbi bazën e dokumentacionit të inventarizuar, i cili përmban dokumentet si më poshtë vijon: a) vendimin e gjykatës, për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg"; b) urdhrin e ekzekutimit të prokurorit; c) procesverbalin e ndalimit ose të arrestimit në flagrancë; ç) procesverbalin e kontrollit personal; d) formularin e identifikimit me 2 (dy) foto dhe gjurmët e gishtërinjve; dh) dokumentin e identifikimit (letërnjoftim, kartë identiteti, pasaportë biometrike ose çdo dokument informacioni lidhur me identitetin); e) dokumentin e kontrollit mjekësor dhe çdo informacion mbi shëndetin e të paraburgosurit, që ka lidhje me mirëqenien e tij fizike dhe mendore.

2. Drejtoria e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në DPB pasi vlerëson gjithë praktikën sipas referimit të pikës 2 të kësaj procedure, bën rekomandimin tek Drejtori i Përgjithshëm për IEVP ku do të vendoset i burgosuri.
3. Kur kërkesa për transferim bazohet në arsye të rënda sigurie, kur rrezikohet jeta ose shëndeti i të burgosurit, ose kur ka mbipopullim në institucion, Sektori i Sigurisë në IEVP përgatit një raport të arsyetuar dhe të hollësishëm ku jepen të dhëna dhe prova për vërtetimin e shkakut për transferim të të burgosurit.
4. Kur kërkesa për transferim bazohet në nevoja hetimi dhe gjykimi, sektori ligjor i IEVP përgatit një raport të arsyetuar dhe të hollësishëm ku jepen të dhëna mbi gjendjen gjyqësore të të burgosurit, dinamikën e vuajtjes së dënimit si dhe për referencat zyrtare të ardhura nga organet e drejtësisë ku është kërkuar transferimi i të burgosurit.
5. Kur kërkesa për transferim bazohet në shkaqe shëndetësore, sektori i kujdesit shëndetësor përgatit një raport të arsyetuar dhe të hollësishëm ku jepen të dhënat e nevojshme mbi gjendjen shëndetësore të të burgosurit, raportet dhe analizat mjekësore që vërtetojnë gjendjen e të burgosurit si dhe nevojën shëndetësore për transferimin e tij.
6. Kur kërkesa për transferim bazohet në shkaqe familjare, të formimit profesional, arsimimin si dhe çdo element tjetër të përfshirë në planin individual si dhe afërsinë me vendbanimin e familjarëve të tij, sektori i kujdesit social përgatit një raport të arsyetuar dhe të hollësishëm, ku jepen të dhëna për gjendjen familjare dhe vendbanimin e tyre, gjendjen sociale, arsimore dhe profesionale, si dhe referencat zyrtare të ardhura nga institucionet shtetërore lidhur me shkaqet e transferimit.
7. Të dënuarit vendosen në IEVP, sipas kategorizimit të përcaktuar nga Ministri i Drejtësisë.
8. Personat e mitur vendosen në IM Kavajë.
9. Të burgosurit femra, vendosen në IEVP për femra.
10. Të paraburgosurit vendosen në paraburgime, ose në seksione të veçanta, në të gjitha raste të ndarë nga të dënuarit.

Neni 44

Vendosja për shkak të sëmundjeve infektive

I burgosuri i cili vuan nga sëmundja infektive, vendoset i veçuar prej personave të dënuar ose të paraburgosur të tjerë, me urdhër të drejtorit të institucionit sipas propozimit të mjekut të institucionit.

Neni 45

Sistemimi në dhomat e banimit

1. Të burgosurit i sigurohet krevat, dyshek, jastëk me këllëfin, çarçafë dhe batanije sipas normativave ligjore dhe komodinë për vendosjen e sendeve personale. Batanijet duhet të shpërndahen sipas stinëve.
2. Të burgosurit para se të vendosen në dhoma, vlerësohen sipas një formati standard për rrezikshmërinë e veprës penale, histori dhune, konflikte, sjellje antisociale si bullizëm, urrejtje, ekstremizëm, probleme të shëndetit mendor, përdorues i lëndëve narkotike, orientimin seksual etj.
3. Vlerësimi sipas pikës 2 të këtij neni bëhet një komision i përbërë nga përgjegjësi i shërbimit social, përgjegjësi i shëndetësisë dhe shefi i policisë, të cilët plotësojnë fletë vendosjen e të burgosurit në sektor dhe dhomën e përshtatshme. Nëse lind nevoja për të ndryshuar dhomën apo sektorin e banimit, komisioni vepron në të njëjtën mënyrë si në vendosjen fillestare, duke rishikuar faktorët dhe treguesit e riskut, sipas formatit të ndarjes në dhoma.

4. Në rast se brenda në dhomën e banimit, ku janë të akomoduar dy ose më shumë të burgosur, ndodh një konflikt i pa parashikuar, ose ka informacione të besueshme për një konflikt, ose rrezik të cenimit të sigurisë, oficeri i regjimit të brendshëm në detyrë, ose oficeri në shërbim në zyrën e informacionit, vë në dijeni shefin e policisë dhe shpërndan të burgosurit, provizorisht deri sa të merret në shqyrtim nga komisioni i akomodimit dhe shpërndarjes.
5. Nga i burgosuri kërkohet që dhomën në të cilën është i akomoduar ta mbajë pastër përfshirë shtratin dhe sendet e tjera personale.
6. Shtretërit duhet të jenë të rregulluar, ndërsa sendet personale me rregull të jenë të vendosur në dollapin për sendet personale.
7. I burgosuri përgjigjet administrativisht për dëmshpërblimin e dëmtimeve të pronës shtetërore dhe nëse dëmtimi është kryer me dashje për të cënuar elementët e sigurisë, atëherë shkelësi kallëzohet edhe penalisht. Zhdëmtimi duhet të kryhet sipas çmimeve të inventarit brenda një muaji nga konstatimi i dëmit.

Neni 46

Hapësira e banimit dhe ndriçimi

1. Dhoma në të cilat jeton i burgosuri duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme që secili i i burgosur të ketë jo më pak se gjashtë (6) metra katrorë hapësirë për dhomë të vetme dhe jo më pak se katër (4) metra katrorë për të burgosurit në dhomë të përbashkëta dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore, artificiale për punë, lexim, ngrohje dhe ajrosje.
2. Dhomat duhet të kenë dritare për ndriçim të mjaftueshëm të cilat mundësojnë hyrjen e ajrit të pastër dhe të dritës e cila mundëson leximin nën dritën natyrore.
3. Gjatë natës ndriçimi në dhomat e banimit fiket, përjashtim të një rasti që ka të bëjë me shëndetin e të burgosurve, ose nëse kjo kërkohet në mënyrë të arsyetuar nga i burgosuri. Ambientet e përbashkëta korridoret, shkallët, hyrjet, ambientet e ajrimit, rrugë kalimet etj. mbahen me ndriçim gjatë natës.

Neni 47

Orari ditor

1. Të gjitha aktivitetet ditore përcaktohen dhe zhvillohen sipas orari të miratuar nga Drejtori i IEVP, të përshtatur me kushtet stimore dhe veçoritë e institucionit.
2. Zgjatja e kohës së ajrimit përcaktohet nga Drejtori i Përgjithshëm, në varësi të nevojave të sigurisë, veprimeve të përbashkëta, punësimit ose vetëpunësimit, nevojave edukative dhe shkaqeve të tjera sipas nevojave të institucionit.
3. Në varësi të stinëve dhe temperaturave, menaxhohet edhe hapja e dyerve të dhomave të të burgosurve, përjashtimisht në rast të konflikteve apo incidenteve ndërmjet të të burgosurve dhe me stafin, ku dyert mbyllen dhe komunikohet e vepohet duke hapur vetëm një derë në rast nevojë.

KAPITULLI V
NJOHJA ME JETËN NË INSTITUCION
DHE
TË DREJTAT E DETYRIMET E TË BURGOSURVE

Neni 48

Njohja me të drejtat dhe detyrimet

1. Menjëherë pas pranimit në institucion (IEVP) i burgosuri njoftohet me shkrim për të drejtat dhe detyrimet që i ka gjatë ekzekutimit të dënimit. I burgosuri që nuk di shkrim dhe lexim informohet gojarisht.
2. Personat e burgosur që janë shtetas dhe nacionalitete të tjera, informohen nëpërmjet një përmbledhje të rregullave të shkruara, në një nga gjuhët ndërkombëtare në pamundësi të gjuhës përkatëse.
3. Të gjitha IEVP hartojnë një fletë palosje me rregullat, të drejta dhe detyrimet, përfitimet, vizitat.
4. Për çdo 15-20 të burgosur caktohet një punonjës i rolit bazë si pikë kontakti, i cili koordinon punën për trajtimin e kërkesave dhe ankesave, vizitave, akomodimin etj. Punonjësi i kontaktit caktohet me urdhër të brendshëm të drejtorit të institucionit, bazuar në aftësite komunikuese, eksperiencën dhe motivimin e tij.

Neni 49

Të drejtat e të burgosurve

1. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, ju garantojnë të burgosurve, pa asnjë dallim të gjitha të drejtat e parashikuara në nenin 20 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, të miratuar me VKM Nr.209, datë 06.04.2022, në Ligjin Nr.81/2020 si dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
2. Të burgosurit trajtohen në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, përkatësie etnike, gjuhe, feje, bindjeje politike, fetare ose filozofike, orientimi seksual, identiteti gjinor, gjendjeje ekonomike, arsimore ose shoqërore, përkatësie prindërore, moshe, gjendjeje familjare ose martesore, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, shtetësie, ose përkatësie në një grup të caktuar, ose për çdo shkak tjetër që përbën diskriminim.
3. Të burgosurve me çrregullime të shëndetit mendor u garantohet trajtim i barabartë, jo diskriminues, duke respektuar integritetin fizik dhe dinjitetin njerëzor. Trajtimi i tyre bëhet sipas standardeve shëndetësore që zbatohen edhe për kategoritë e tjera të personave me çrregullime të shëndetit mendor.
4. Të burgosurve me aftësi të kufizuara u garantohen liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, trajtimi jo diskriminues për shkak të aftësisë së kufizuar, duke plotësuar nevojat specifike për aftësimin dhe riaftësimin e tyre.
5. Të burgosurit me shtetësi të huaj, ose pa shtetësi trajtohen duke mbajtur parasysh situatën e tyre të veçantë dhe nevojat individuale. Punonjësit e institucionit ndërmarrin veprime të nevojshme për të shmangur diskriminimin dhe për të zgjidhur probleme specifike, me të cilat këta persona përballen në institucion, gjatë transferimit dhe pas liritë.
6. Masat e veçanta, që janë të nevojshme të zbatohen për respektimin e lirive dhe të drejtave të grupeve të veçanta të të burgosurve, nuk konsiderohen diskriminim sipas kësaj rregulloreje.

7. Gjatë qëndrimit në institucion të burgosurit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kanë këto të drejta:
- a. u sigurohet takimi, korrespondenca, bisedat telefonike me avokatët duke pasur kohë të mjaftueshme dhe në konfidencë të plotë;
 - b. informohen në kohë dhe vazhdimësi për të drejtat e tyre;
 - c. u sigurohet fjetje në krevat të veçantë me rroba fjetje, sipas kushteve klimaterike, si dhe ndriçim të përshtatshëm;
 - d. u sigurohet ushqim 3 (tre) herë në ditë, sipas normave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore, për trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve;
 - e. të kenë llogari bankare personale, të cilën mund ta përdorin për nevojat e tyre;
 - f. të takohen me anëtarët e familjes, ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes;
 - g. t'u sigurohet shërbimi i kujdesit shëndetësor 24 (njëzet e katër) orësh;
 - h. të paraqesin kërkesa dhe ankesa tek personeli i institucionit dhe pranë çdo institucioni tjetër;
 - i. t'u sigurohet e drejta dhe fshehtësia e korrespondencës;
 - j. e drejta e bisedave telefonike;
 - k. e drejta e ajrimit;
 - l. të marrin pjesë në aktivitete argëtuese dhe edukative, që organizohen nga institucioni;
 - m. e drejta e punësimit dhe punës, për sa është e mundur;
 - n. e drejta e lirisë së besimit dhe ushtrimit të riteve fetare;
 - o. e drejta e ndihmës social-psikologjike;
 - p. e drejta e përdorimit të sendeve personale të lejuara, sipas parashikimeve në këtë rregullore;
 - q. çdo e drejtë tjetër e parashikuar në legjislacionin në fuqi.
 - r. E drejta e votës sipas parashikimeve në Kodin Zgjedhor dhe akteve të tjera ligjore.
 - s. Shtetaset e huaja kanë të drejtë të marrin kontakte me përfaqësitë diplomatike të vendit të tyre, dhe gëzojnë të njëjtat të drejta dhe detyrime me të burgosurit e tjera, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë rregullore.

Neni 50

Detyrimet e të burgosurve

Të burgosurit kanë detyrimin të zbatojnë rregullat e institucionit si dhe të kenë sjellje korrekte me të burgosurit e tjerë dhe personelin e institucionit, siç parashikohet në nenin 83 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, të miratuar me VKM Nr.209, datë 06.04.2022 dhe në Ligjin Nr.81/2020.

1. Të burgosurit nxiten që të përfshihen në aktivitete edukative, kulturore, sportive dhe punësimi.
2. Të burgosurit kanë detyrimin të zbatojnë rregullat e institucionit, si dhe të kenë sjellje korrekte me të burgosurit e tjera dhe personelin e institucionit.
3. I burgosuri gjatë qëndrimit në institucion, detyrohet:
 - a. të mbajë të pastër e të rregullt mjedisin e banimit dhe mjediset e përbashkëta;
 - b. të kujdeset për higjienën personale;
 - c. të mos mbajë dhe qarkullojë sende të ndaluara, të cilat rrezikojnë rendin, jetën dhe shëndetin e të burgosurve dhe personelit, objekte që përbëjnë vepër penale, mjete që ndikojnë negativisht në hetim, si dhe vlera monetare të çdo lloji;
 - d. të krijojë marrëdhënie korrekte me të burgosurit e tjera, si dhe me personelin e institucionit;
 - e. të zbatojë udhëzimet e personelit të institucionit;

- f. të dëmshpërblejë vlerën përkatëse në rastet e dëmtimit të materialeve që janë pronë e institucionit, ose e të burgosurve të tjerë;
- g. të zbatojë programet ditore të institucionit;
- h. të respektojë dinjitetin e pjesëtarëve të komunitetit dhe të personelit;
- i. të informojë menjëherë drejtorin e institucionit për rrethanat që mund të rrezikojnë sigurinë, jetën e të burgosurve, ose shkeljen e rregullave të brendshme në institucion.

KREU VI

USHQIMI, TRAJTIMI SHËNDETËSOR DHE ZBATIMI I MASAVE HIGJIENTIKE

Neni 51

Ushqimi

1. Të burgosurve u sigurohet ushqim për tri vaktet, sipas normave dhe llojshmërisë, të përcaktuara në urdhrin e përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
2. I burgosuri mund të blejë produkte ushqimore, cigare dhe sende të tjera tek operatori i kontraktuar me të ardhurat që ka në llogarinë e tij.
3. Institucioni u siguron të burgosurve të sëmurë dietë të veçantë, sipas rekomandimeve të mjekut.
4. Menyja sipas vakteve përcaktohet nga personeli i institucionit, në përputhje me normat e ushqimit të parashikuara në urdhrin e përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë.
5. Në qoftë se i burgosuri, për shkak të ndërgjegjes ose besimit fetar, kërkon një ushqim të ndryshëm, kjo kërkesë respektohet nga personeli i institucionit në përputhje me rregullat fetare dhe mundësitë praktike të institucionit.
6. Sektori i shëndetësisë, i policisë dhe i logjistikës, përpilojnë një raport të përbashkët, të hollësishëm, për sasinë e ushqimit, të ndarë sipas kategorive të të burgosurve.
7. Personeli në institucionin për të mitur, merr parasysh ofrimin e ushqimit në përshtatje me nevojat e të miturve, duke sjellë një meny dhe asortimente më të larmishme.

Neni 52

Shpërndarja e ushqimit

1. Ushqimi përgatitet në kuzhinë dhe jepet si rregull në mjedise të banimit, duke u shpërndarë individualisht në enë personale të të burgosurit.
2. Të burgosurit të sëmurë, të miturve, grave shtatzënave, ushqimi u sigurohet sipas rekomandimit të mjekut.
3. Menyja sipas vakteve e ushqimit ditor përcaktohet në menynë javore.
4. Të burgosurve duhet t'u sigurohet në vazhdimësi ujë i pijshëm.

Neni 53

Higjiena

1. Të burgosurve u sigurohen pajisje dhe mjetet e nevojshme për higjienën personale dhe të ambienteve.
2. Çdo institucion siguron shërbime periodike të pastrimit të hapësirave, veshmbathjes dhe pajisjeve personale, si dhe të qethjes dhe organizon kontrollin e tyre, jo më pak se një herë në javë.
3. Higjiena personale, mund të bëhet me detyrim vetëm për arsye të veçanta higjienë sanitare, sipas kërkesës së shërbimit shëndetësor dhe me urdhër të drejtorit të institucionit.

4. I burgosuri është i detyruar që për çdo ditë të mbajë higjienën personale dhe të përgjithshme.
5. Ndërresat, çarçafët dhe këllëfi i jastëkut ndërrohen të paktën një herë në pesëmbëdhjetë (15) ditë, ndërsa batanijet të paktën çdo 3 muaj. Rrobat dhe ndërresat personale të personit të burgosur lahen dhe thahen në lavanterinë e institucionit.
6. Të burgosurit kanë të drejtë të lahen në dushe jo më pak se dy herë në javë dhe në çdo rast kur kthehen nga ushtrime fizike, sporti, apo puna. Dushet duhet të jenë të përshtatshme dhe të garantojnë privatësinë e personit.
7. Të burgosurat femra kanë të drejtë të mbajnë sende të nevojshme, për higjiene dhe tualet të dedikuar për gjininë femërore.

Neni 54

Shërbimet e kujdesit shëndetësor

Shërbimet e kujdesit shëndetësor, ofrohen sipas parashikimeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me VKM Nr.209, datë 06.04.2022 dhe në Ligjin Nr.81/2020.

1. Shërbimi shëndetësor sigurohet nga institucioni gjatë gjithë kohës së qëndrimit në institucion, duke përfutur të njëjtin trajtim dhe kujdes shëndetësor që zbatohen për shoqërinë në përgjithësi. Kjo mbulohet nga sigurimi i detyrueshëm i kujdesit shëndetësor sipas legjislacionit në fuqi.
2. Kushtet, mjetet dhe personeli për mbrojtjen e shëndetit të të burgosurve sigurohen nga shteti.
3. Shërbimi shëndetësor i përgjigjet çdo kërkesë të të burgosurve, që lidhet me shëndetin e tyre dhe në mënyrë periodike ushtron kryesisht kontrollë shëndetësore për të parë gjendjen e përgjithshme të të burgosurve, veçanërisht atë shëndetit mendor. Çdo kontroll duhet të dokumentohet në kartelën shëndetësore të të burgosurit.
4. Shërbimet e kujdesit shëndetësor sigurojnë:
 - a. Parandalimin, diagnostikimin dhe mjekimin e sëmundjeve
 - b. Furnizimin me barna dhe pajisje mjekësore në rastet e emergjencës shëndetësore kur ato nuk mbulohen nga sigurimi i detyrueshëm i kujdesit shëndetësor.
 - c. Profilaksinë për sëmundjet, duke bërë kujdes të veçantë për sëmundjet infektive dhe ato ngjitëse.
 - d. Sigurimin e higjienës së mjedisit dhe edukimin sanitar të të burgosurve.
 - e. Mbajtjen nën kontroll të sëmurëve kronik.
5. Mjeku i raporton drejtorit të institucionit kurdoherë që mendon se gjendja fizike e mendore e një të burgosuri është përkeqësuar, ose do të keqësohet nga vazhdimi i qëndrimit në IEVP.
6. Në institucion funksionon shërbimi 24 orësh kujdesit shëndetësor. Orari i vizitave është nga ora 09:30-14:00. Mbas këtij orari, mund të kryhen vetëm vizita urgjente.
7. Vizitat mjekësore kryhen tek dhoma e mjekut dhe e stomatologut, pa prezencën e punonjësve të sigurisë, apo personave të tjerë. Përjashtim mund të bëhet në rast se vlerësohet se pacienti mund të përbëjë rrezik për stafin shëndetësor dhe kërkohet nga mjeku.
8. Çdo mëngjes, personeli shëndetësor hyn në ambientin ku qëndrojnë të burgosurit ku kontrollon higjienën dhe pastërtinë si dhe merr nga të burgosurit kërkesat për vizitë mjekësore dhe stomatologjike.
9. Pranë institucionit funksionon shërbimi stomatologjik. Ky shërbim ofrohet çdo ditë nga ora 09:30-14:00. Shërbimet/trajtimet e specializuara që nuk mund të ofrohen në Institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, me kërkesë të burgosurit dhe në bazë të rekomandimit të mjekut stomatolog dhe miratimit të drejtorit të institucionit, i burgosurit me shpenzimet e tij, mund të dërgohet për trajtim në institucione private në vendin më të afërt me institucionin IEVP.

10. Institucioni ka shërbim farmaceutik, që i përgjigjet nevojave për parandalimin dhe ruajtjen e shëndetit të të burgosurve.
11. Çdo i burgosur ka të drejtë të kërkojë vizita nga mjekë specialistë, kundrejt shpenzimeve të tij. Në raste urgjente, ose kur kërkohet nga mjeku specialist, i burgosuri dërgohet për vizitë në spitalet publike, me propozim të mjekut dhe me miratimin të drejtorit të institucionit në përputhje me procedurat e shoqërimit dhe mbikëqyrjes në spitale.
12. Në raste urgjente, jashtë orarit zyrtar, personeli shëndetësor me miratimin e specialistit të Informacionit, realizon lëvizjen e të burgosurit të sëmurë sipas rastit në spitalin publik konform rregullave të sigurisë.
13. I burgosuri që dyshohet ose ka sëmundje ngjitëse, izolohet menjëherë në mjedise të posaçme dhe trajtohet sipas standardeve të njëjta me personat e të njëjtës kategori jashtë institucionit.
14. Në rastet e sëmundjeve infektive, kur diagnostikimi dhe mjekimi nuk mund të sigurohen në kushtet e institucionit, i burgosuri shoqërohet në Qendrën Spitalore të Burgjeve.
15. I burgosuri i sëmurë është i detyruar të zbatojë udhëzimet e mjekut gjatë terapisë. Pa lejen e mjekut, i burgosuri nuk mund të mbajë asnjë lloj medikamenti dhe nuk mund t'i përdorë ato. Medikamentet i jepen të burgosurit të sëmurë nga personeli shëndetësor sipas llojit, mënyrës dhe kohës së rekomanduar nga mjeku në kartelën e të sëmurit. Medikamentet merren në farmacinë e institucionit nga infermieri, sipas recetës së lëshuar nga mjeku.
16. Të burgosurve u lejohet të marrin medikamente nga të afërmit ose t'i blejnë vetë ato me shpenzimet e tyre, në rastet kur këto medikamente nuk rimbursohen dhe nuk disponohen në farmacinë e institucionit. Këto medikamente, mund të përdoren vetëm me rekomandim të mjekut të institucionit. Mbajtja e medikamenteve në dhomën e të burgosurit për vetë administrim, apo çdo lloj abuzimi tjetër, duke përfshirë edhe dhënien e tyre të burgosurve të tjera, është i ndaluar.
17. Të burgosurit ish përdorues të lëndëve narkotike, mund të trajtohen me metadon apo barna, vetëm me rekomandim të mjekut specialist me dozën e rekomanduar. Medikamenti metadon administrohet vetëm nga stafi shëndetësor dhe aplikohet në ambientin e infermierisë në prani të personelit shëndetësor, me nënshkrimin e të burgosurit. Vetë administrimi i metadonit nga i burgosuri, nuk lejohet.
18. Ndalohen eksperimentet shëndetësore që përfshijnë të burgosurit dhe që mund të shkaktojnë dëmtime fizike, çrregullime mendore, ose dëmtime të tjera.

Neni 55

Kërkesa për vizitë mjekësore

1. I burgosuri që ka probleme shëndetësore paraqet kërkesën me shkrim ose me gojë për vizitë mjekësore tek personeli shëndetësor ose personeli i sigurisë në regjim. Personeli shëndetësor i turnit, harton listën përkatëse dhe ja dorëzon mjekut të IEVP-së për të bërë vizita, me përjashtim të rasteve urgjente.
2. Lëvizja e të burgosurve nga dhoma për në infermieri dhe anasjelltas, me përjashtim të rasteve urgjente, bëhet një nga një, sipas kërkesës së mjekut. Gjatë vizitës mjekësore, punonjësi shoqëruar qëndron jashtë dhomës deri në mbarimin e vizitës.
3. I burgosuri nuk mund të mbajë apo të përdorë asnjë lloj medikamenti mjekësor pa miratimin e mjekut.

Neni 56

Kujdesi shëndetësor për kategori të veçanta

1. Shërbimi shëndetësor në institucion (IEVP) organizohet pa diskriminim për shkak të statusit ligjor të personit, ose për ndonjë arsye tjetër, që mund të përbëjë diskriminim.
2. Trajtimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor bëhet sipas legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor. Të burgosurit që gjenden në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, gëzojnë të drejtën për trajtim të veçantë shëndetësor dhe mbahen në sektor të kujdesit të veçantë (SKV).
3. Trajtimi shëndetësor i të burgosurve përfshin kontroll të plotë për të përcaktuar nevojat e kujdesit shëndetësor parësor duke përfshirë, por pa u kufizuar në kontrollet për:
 - a. SST
 - b. Sëmundje të lindura të gjakut
 - c. Kujdesi ndaj shëndetit mendor
 - d. Çrregullime post-traumatike
 - e. Rrezikun e vetëdëmtimit ose vetëvrasjes
 - f. Praninë e varësisë ndaj lëndëve narkotike
 - g. Abuzimin seksual dhe forma të tjera të dhunës që mund të kenë pasur përpara pranimi në institucion.
4. Grave dhe të miturave të burgosura ju ofrohen programe dhe shërbime në përputhje me moshën e tyre. Ato informohen për kujdesin shëndetësor, për parandalimin e sëmundjeve të ndryshme, higjienën vetjake, për format e dhunës dhe çdo lloj abuzimi.
5. Të burgosurve ju sigurohet kontroll periodik nga mjeku psikiatër dhe mjek specialist.
6. Të burgosurit që shfaqin shenja të përdorimit të drogës, substancave psikotrope ose alkoolit, apo shenja të stresit, trajtohen sipas programeve shëndetësore dhe sociale që zbatohen në shoqërinë jashtë institucionit.
7. Personat që mbartin sëmundje infektive trajtohen në mënyrë jo diskriminuese dhe sipas standardeve që zbatohen për këto kategori në institucionet spitalore.
8. Gjatë pranimi, i burgosuri vlerësohet lidhur me rrezikun për vetëdëmtime dhe vetëvrasje në një format standard. Në rast të identifikimit të shenjave, mendimeve, rrethanave sociale dhe psikologjike, merren masa të menjëhershme për sistemimin, monitorimin dhe zbatimin e një plani ndërhyrje. Të burgosur të kësaj kategorie në asnjë rrethanë nuk sistemohen në dhomë të vetmuar dhe mbahen në vëzhgim nga punonjësi i sigurisë, duke e mbajtur derën të pa kyçur.
9. Rastet e refuzimit të ushqimit trajtohen sipas protokollit standard të miratuar.
10. Rastet e kufizimit fizik të personave me problemet të shëndetit mendor, bëhet në përputhje me ligjin për shëndetin mendor, me rekomandim të mjekut psikiatër sipas formatit standard të miratuar nga DPB. Mënyrat e kufizimit fizik, janë përdorimi i medikamenteve, imobilizimi fizik, përdorimi i mjeteve/pajisjeve të kufizimit fizik dhe izolimi. Nuk lejohet përdorimi i prangave metalike, apo plastike për kufizimin fizik të të burgosurve me probleme të shëndetit mendor.
11. Për koordinimin e punës për trajtimin e të burgosurve me probleme të shëndetit mendor, caktohet një punonjës si koordinator i ekipit multidisiplinar.

Neni 57

Vizitat mjekësore jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale

1. Të burgosurve ju lejohet që, me shpenzimet e veta, të kryejnë vizita dhe mjekime të specializuara në klinika të tjera jashtë institucionit, me miratimin e drejtorit të institucionit, nëqoftëse shërbimi nuk mund të ofrohet në spitalet publike, gjithnjë duke marrë në konsideratë afërsinë me institucionin.
2. Transporti dhe ruajtja e të burgosurve bëhet nga institucioni me shoqërim nga personeli shëndetësor dhe punonjësit e policisë.
3. Gjatë mbikëqyrjes së të burgosurit si pacient në spitale publike apo private, nuk lejohet përdorimi i mjeteve të kufizimit fizik dhe fiksimit të pacientit në krevat. Për raste që vlerësohen me rrezikshmëri për arratisje apo për jetën e stafit, merren masa për të shtuar personelin mbikëqyrës.

Neni 58

Medikamentet mjekësore, sigurimi dhe shpërndarja e tyre

1. Pas vizitës mjekësore, mjeku i institucionit ose mjeku specialist sipas llojit të sëmundjes së të burgosurve, rekomandon trajtimin e nevojshëm, që përshkruhet në kartelën mjekësore të të burgosurit. Njëkohësisht u jepen rekomandimet e rastit personelit shëndetësor dhe farmacistit për veprimet e mëtejshme.
2. Administrimi i medikamenteve bëhet nga farmacia e institucionit, ndërsa shpërndarja bëhet nga personeli shëndetësor.
3. Me miratimin dhe udhëzimin e mjekut të institucionit të burgosurit lejohen të trajtohen me medikamente të siguruara me shpenzimet e tyre.

Neni 59

Veçimi mjekësor

1. Në rastet e sëmundjeve ngjitëse mjeku vendos për veçimin e të burgosurit, duke e mbajtur nën kontroll të vazhdueshëm dhe njofton menjëherë drejtorin e institucionit për situatën.
2. Në rastet e konstatimit të sëmundjeve ngjitëse dhoma dezinfektohet, ndërsa i burgosuri vendoset në një mjedis të veçantë ose dërgohet në Qendrën Spitalore të Burgjeve për trajtim të specializuar.
3. Mjeku vendos për pushimin e veçimit kur nuk ekzistojnë më shkaqet që çuan në vendosjen e veçimit.

Neni 60

Konfidencialiteti i të dhënave mjekësore

1. Kartela mjekësore e të burgosurit administrohet vetëm nga mjeku dhe ruhen të mbyllura sipas rekomandimit të Komitetit për Parandalimin e Torturës.
2. Fotokopje e kartelës mjekësore, i vihet në dispozicion vetëm gjykatës dhe prokurorisë me kërkesë me shkrim. Mbrojtësit ligjor të të burgosurit i vihet në dispozicion informacion shëndetësor bazuar në kartelën mjekësore dhe jo fotokopje të kartelës.

Neni 61

Kërkesat dhe ankesat

1. Kërkesat dhe ankesat bëhen sipas përcaktimeve të ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve.
2. Drejtori i institucionit, i trajton vetë ose delegon kërkesat apo ankesat për ndjekje sektorit përkatës për verifikim, zgjidhje dhe raportim.

3. Sekretaria e institucionit mban dhe përditëson regjistrin e kërkesave ose ankesave të të burgosurve, në formë shkresore dhe elektronike. Formatit dhe përmbajtja e regjistrit është sipas përcaktimeve në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.
4. Afati i shqyrtimit të ankesave varet nga lloji i kërkesave, por nuk mund të kalojë afatet e parashikimit në ligj. Kërkesa dhe ankesa të cilat janë në kompetencë të sektorëve të IEVP duhet të trajtohen brenda afatit nga një deri në 5 ditë pune. Kërkesa dhe ankesa të cilat janë në kompetencë të Drejtorit të IEVP duhet të trajtohen nga një ditë deri në 10 ditë. Kërkesa dhe ankesa që janë jashtë IEVP, trajtohen brenda afatit të parashikuar në aktet ligjore.

KREU VII

TRAJTIMI I TË BURGOSURVE

Neni 62

Korrespondenca

1. Çdo i/e burgosur ka të drejtë të mbajë korrespondencë dhe t'i garantohet fshehtësia e saj.
2. Për të burgosurit që nuk i kanë mundësitë, personeli i institucionit, vë në dispozicion mjetet e nevojshme për korrespondencë.
3. Korrespondenca duhet të hidhet në kutinë postare të IEVP-së, e cila merret nga një punonjës i institucionit. Shpërndarja e korrespondencës së ardhur bëhet nga punonjësi i institucionit të ngarkuar me këtë detyrë, duke ruajtur fshehtësinë e saj.
4. Në rastet kur ka dyshime të bazuara se në korrespondencë ka sende të ndaluara, ajo hapet në prani të të burgosurit dhe të drejtorit të institucionit.
5. Drejtori i institucionit, me vendim të prokurorit ose të gjykatës, mund të kufizojë të drejtën e të burgosurit për korrespondencë, nëse kjo është e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale penale.
6. Të burgosurit kanë të drejtë të marrin me postë pako nga familjarët, e cila mund të përmbajë veshje sende për higjienë dhe libra, për aq sa kjo e drejtë nuk shpërdorohet nga familjarët ose të burgosurit. Nuk lejohet marrja e ushqimeve me pako nga posta apo familjarët.
7. Marrja e pakos me postë bëhet nga personi i ngarkuar për tërheqjen e korrespondencës së të burgosurve dhe i jepet personit që i adresohet dhe hapet në prezencë të punonjësit që e ka tërhequr dhe të burgosurit që i adresohet kundrejt nënshkrimit të të burgosurit në një regjistër të posaçëm.

Neni 63

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Personeli i institucionit duhet të zbatojë legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë edhe vendimet, apo udhëzimet e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me qëllim arritjen e një niveli sigurie të përshtatshëm gjatë përpunimit të të dhënave personale të të burgosurve, nëpërmjet përdorimit të mjeteve të punës.
2. Veprimi apo mosveprimi, në kundërshtim me këtë dispozitë, përbën shkelje disiplinore dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi që rregullon marrëdhënien e punës së personelit.

Neni 64

Përdorimi i të dhënave personale

1. Të dhënat personale lidhur me të burgosurit duhet të administrohen në përputhje me kërkesat ligjore dhe me ato mund të njihen Ministri i Drejtësisë, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Drejtori i Policisë, Drejtori i institucionit, Shefi i Policisë, Përgjegjësi i Sektorit Ligjor dhe çdo autoritet tjetër në përputhje me legjislacionin në fuqi, ose nga personat e autorizuar prej tyre.
2. Personat të cilët, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, vihen në dijeni me të dhënat personale, detyrohen të ruajnë dhe të mos i nxjerrin këto të dhëna pas përfundimit të detyrës. Këto të dhëna mund të nxirren vetëm në rastet e parashikuara me ligj.
3. Të dhënat personale për çdo të burgosur administrohen në regjistra të certifikuar dhe të miratuar.
4. I burgosuri ose një person i autorizuar prej tij, mund t'i kërkojë Drejtorit të Institucionit të njihet me të dhënat personale të tij, pasi i deklaron drejtorit shkaku dhe llojin e informacionit që i duhet. Drejtori i Institucionit duhet të sigurohet që informacioni i dhënë nuk lidhet me një të burgosur tjetër.
5. Në rast se informacioni kërkohet nga një person i tretë, për dhënien e tij duhet marrë më parë pëlqimi me shkrim i të burgosurit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga dispozitat ligjore në fuqi.
6. Për dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë, për administrimin e të dhënave të tyre personale zbatohet legjislacioni në fuqi.

Neni 65

Mjetet monetare

1. I burgosuri lejohet të depozitojë mjete monetare në llogari personale në një institucion bankar. Në rastin e hapjes së llogarive në një institucion bankar, marrëdhëniet midis institucionit bankar dhe IEVP-së rregullohen me marrëveshje të përbashkëta, ku parashikohet mënyra e deponimit dhe përdorimit të mjeteve monetare nga të burgosurit.
2. Mjetet monetare përdoren nga të burgosurit për blerje të sendeve, të cilat lejohen nga kjo rregullore. Të burgosurit kanë të drejtë t'i dërgojnë mjete monetare familjes.
3. Ndalohet kategorikisht, administrimi i parave në dorë (cash), nga të burgosurit brenda ambienteve të banimit. Paratë e gjetura tek të burgosurit, do të trajtohen si send i ndaluar dhe pasi sekuestrohen kalojnë në kartotekën e institucionit në sektorin ligjor.
4. Pas lirimit, të burgosurve u kthehen të gjitha paratë e mbetura në kartotekën e institucionit.
5. Paratë e depozituara në llogarinë e të burgosurve përdoren prej tyre për realizimin e nevojave për blerjen e artikujve ushqimorë, veshmbathjeve e sendeve të tjera.
6. Çdo i/e burgosur ka të drejtë që nga llogaria e tij vetjake t'i dërgojë familjes ose të afërmeve, nëpërmjet postës, ose duke ua dhënë familjarëve kur vijnë për takim, nëpërmjet një dokumenti të firmosur nga i burgosuri dhe personi që i tërheq paratë. Kjo sasi lekësh do të zbritet nga llogaria personale e tij.

KREU VIII

KONTAKTET ME BOTËN E JASHTME

Neni 66

Takimi me familjen, të afërmit dhe miqtë

1. Të burgosurit kanë të drejtë të takohen të paktën katër herë në muaj me anëtarët e familjes, ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes së tyre.
2. Kohëzgjatja e takimit është të paktën 1 (një) orë.

3. Të paraburgosurit lejohen të takohen me anëtarët e familjes, ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes vetëm me miratim nga prokurori i çështjes.
4. Kur organizimi i institucionit e lejon, i burgosuri mund të qëndrojë me familjarët përtej kufirit kohor të parashikuar. Vizitat zhvillohen në ambiente të veçanta nën mbikëqyrjen e personelit të institucionit, sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.
5. Për vizitat që zhvillohen nga fëmijët e tyre, mundësohen takime më të shpeshta deri 6 herë në muaj.
6. Drejtori i institucionit mund të japë takime shitesë të arsyetuara për të burgosurit, ose bashkim takimesh.
7. Takimet e zgjatura lejohen 1 herë në muaj dhe jo më shumë se 4 orë për të dënuarit e martuar ose bashkëjetues, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Kodin e Familjes, pasi bashkëjetesa e tyre të jetë verifikuar nga Policia e Shtetit.
8. Takimet do të zhvillohen çdo ditë ora 07:30 -15:00 dhe ditën e shtunë vetëm për raste të veçanta të argumentuara (caktime me vendime gjykatë për takim të fëmijëve) nga ora 09:00-13:00. Regjistrimet e takimeve do të kryhen nga ora 07.00 deri 14.00
9. Në çdo takim, lejohen fëmijët e mitur dhe tre persona madhorë.
10. Drejtori i Institucionit, me vendim të prokurorit apo të gjykatës, kufizon të drejtën e të burgosurit që të presë vizita, nëse kjo është e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale penale.
11. Familjarët dhe të afërmit duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi, i cili provon lidhjen me të burgosurin.
12. Me miratimin e Drejtorit të institucionit, kur shihet e arsyeshme, mund të takohen me të burgosurin edhe persona të tjetër që nuk përfshihen në pikën 1 të këtij neni.
13. Takimet kryhen në vendin e caktuar për kryerjen e takimeve të zakonshme.
14. Për nënat të cilat kanë fëmijë deri në 18 vjeç, dhe fëmijët e tyre ndodhen jashtë Shqipërisë në kushtet kur e kanë të pamundur të realizojnë takime me to, lejohet komunikimi online në adresën zyrtare të institucionit e hapur për këtë qëllim, deri në dy herë në muaj me kohëzgjatje deri në 60 minuta. Ky proces realizohet në ambientin e takimeve me familjarë, monitorohet nga stafi i kujdesit social dhe punonjësi i vëzhgimit të takimeve.
15. I mituri ka të drejtë:
 - a) të ketë 8 vizita nga familjarë/rrethi shoqëror në muaj dhe si motivim nxitës 2 vizita shitesë në muaj. Në rast pamundësie të familjarëve dhe rrethit shoqëror për të kryer vizitat në orën e parashikuar, organi kompetent bën të mundur garantimin e së drejtës për takim në një kohë të përshtatshme për ta dhe të miturin;
 - b) të ketë 4 vizita në vit pranë familjes dhe si motivim vizita shitesë;
 - c) të ketë të paktën 1 vizitë në rastet e problemeve shëndetësore ose emocionale;

Neni 67

Procedurat për vizitat me anëtarët e familjes ose të afërmit

1. Vizitat e të burgosurit, me anëtarët e familjes, apo të afërmit bëhen me rezervim paraprak në platformën e-albania, ose me planifikim nëpërmjet kërkesës së të burgosurit apo familjarëve.
2. Jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë përpara vizitës, i burgosuri rezervon takimin me familjarët apo të afërmit. Rezervimi mund të bëhet nga vetë i burgosuri, anëtarët e familjes, ose nga persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes.
3. Me kryerjen e rezervimit të takimit nga i burgosuri, anëtari i familjes ose personat e ndryshëm nga anëtarët e familjes, verifikohet identiteti i personit, bëhet verifikimi i numrit të takimeve në regjistrin

e indeksit alfabetik dhe më pas bëhet regjistrimi në regjistrin e takimeve të të burgosurve me familjarët.

4. Më pas, njoftohet përgjegjësi i regjimit të brendshëm, i cili lajmëron të burgosurin mbi ardhjen e familjarëve apo të afërmeve/personave të ndryshëm nga anëtarët e familjes dhe merr masa për organizimin e takimit.
5. Personat vizitorë para takimit i nënshtrohen kontrollit fizik. Këtij kontrolli i nënshtrohet edhe pako që ka me vetë vizitori. Kontrolli i ushqimeve dhe i sendeve, bëhet nga kontrollorët në prezencë të oficerit të informacionit.
6. Shoqërimi i vizitorit nga dhomat e kontrollit deri në dhomën e takimit do të bëhet nga punonjës të rolit bazë në detyrë.
7. Shoqërimi i të burgosurit nga vendi i banimit për në dhomën e takimit bëhet nga punonjësi i rolit bazë, pasi është kontrolluar më parë i burgosuri.
8. Në rast se gjatë zhvillimit të takimit konstatohen shkelje e rregullave, pezullohet takimi, veçohet i burgosuri dhe largohen familjarët.
9. Çdo familjar pas mbarimit të takimit i nënshtrohet kontrollit para daljes nga ambientet e regjimit të brendshëm.
10. Pas largimit të vizitorit, të burgosurit i bëhet kontrolli nga punonjësi i rolit bazë, në prani të përgjegjësit, i cili e shoqëron pas kontrollit për në dhomën e banimit.
11. Në rastet kur konstatohet se nga vizitorët tentohet të futen sende të ndaluara që i posedojnë vetë, pezullohet takimi dhe ndiqen procedurat ligjore, njoftohet prokuroria, ndalohet personi dhe bëhet kallëzim penal.
12. Kur vizitori tenton të fusë sende të ndaluara, Drejtori i institucionit vendos moslejimin e takimeve për këtë vizitor për një periudhë nga 3 deri në 6 muaj.

Neni 68

Vëzhgimi i takimeve

1. Takimet zhvillohen në vendet e caktuara nën mbikëqyrjen vizuale të personelit mbikëqyrës.
2. Në rast se personeli mbikëqyrës i policisë konstaton se vizitorët tentojnë, apo kryejnë shkëmbime sendesh të ndaluara me të burgosurin, ndërpret menjëherë takimin dhe njofton Specialistin e Informacionit.
3. Pas përfundimit të kohës së takimit, personeli mbikëqyrës njofton specialistin e informacionit për shoqërimin e të burgosurit në regjimin e brendshëm dhe për shoqërimin dhe daljen e vizitorëve nga institucioni.

Neni 69

Ndalimi i vizitave

Drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale është kompetent për të ndaluar vizitat për shkaqe të justifikueshme.

Neni 70

Shkaqet e ndalimit të vizitave të përkohshme për vizitorët

1. Shkaqet e ndalimit të vizitave janë:

- a. Në rast të informacioneve se i burgosuri apo vizitori gjatë realizimit të vizitës mund të rrezikojë sigurinë e institucionit apo të vizitorëve.
 - b. Në rast të informacioneve për planifikim ose të kryerjes së ndonjë vepre penale;
 - c. Në rast se vizitori bënë përpjekje që të fusë sende të ndaluara në institucion;
 - d. Vizitat që paraqesin kërcënim për shëndetin fizik dhe mental për të burgosurin dhe vizitorin;
 - e. Në çdo rast tjetër që mund të paraqes rrezik për institucionin apo vizitorët.
2. Drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale me vendim përcakton kohëzgjatjen për ndalimin e vizitës varësisht prej shkaqeve për të cilat është ndaluar.
 3. Drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale duhet ta informojë të burgosurin dhe vizitorin për arsye e ndalimit të vizitës.
 4. Ndalimi i vizitës nuk konsiderohet masë disiplinore.

Neni 71

Ndërprerja e përgjithshme e vizitave

1. Drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale pasi njofton Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve, bën ndërprerjen e përgjithshme të vizitave për të gjithë të burgosurit kur siguria e institucionit është e rrezikuar dhe nëse nuk ka alternativë tjetër kufizuese në dispozicion.
2. Ndërprerja e përgjithshme e vizitave duhet të vazhdojë përderisa vazhdon rreziku.
3. Në rast të shfaqjes së ndonjë sëmundje epidemiologjike në vend, me qëllim parandalimin e përhapjes të saj, drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale në koordinim me Drejtorin e Përgjithshëm bën ndalimin e vizitave të përkohshme.

Neni 72

Bisedat telefonike

1. Të burgosurve ju lejohe të komunikojnë në telefon me anëtarë të familjes, të afërmit dhe në raste të veçanta me të tretë. Të paraburgosurit dhe të dënuarit e sigurisë së lartë, kanë të drejtë të komunikojnë në telefon 8 herë në muaj. Të dënuarit e sigurisë së zakonshme mund të komunikojnë në telefon 10 herë në muaj. Të dënuarit e sigurisë së ulët dhe gratë e dënuara dhe të paraburgosura, kanë të drejtë të komunikojnë në telefon 12 herë në muaj. Të dënuarit e burgut të hapur kanë të drejtë të komunikojnë në telefon 16 herë. Çdo telefonatë duhet të zgjasë jo më shumë se 15 minuta.
2. Të burgosurit duhet të deklarojnë numrat e telefonit dhe poseduesit e tyre tek stafi i shërbimit social ose oficeri i kontaktit i cili koordinon punën me operatorin me qëllim regjistrimin e numrave të konfirmuar, në sistemin PIN. Të burgosurit nuk mund të flasin me një numër telefoni, i cili nuk është deklaruar tek stafi.
3. I mituri ka të drejtë të kryejë jo më pak se 4 thirrje telefonike në javë, pa pagesë, ku secila prej tyre nuk i kalon 15 minuta, dhe të ketë si motivim nxitës biseda telefonike pa limit me shpenzimet e veta. Në rast të mungesës së të ardhurave, të miturit i sigurohet kjo e drejtë falas nga organi kompetent, pranë të cilit i mituri ndodhet. Të kryejë 4 videokonferenca në muaj dhe si motivim nxitës 2 videokonferenca shtesë në muaj.
4. Drejtori i institucionit mund të lejojë kryerjen e bisedave telefonike shtesë, kur e vlerëson të nevojshme në funksion të mirëqenies psiko sociale dhe mbajtjes së lidhjeve me familjen.
5. Bisedat telefonike zhvillohen nën mbikëqyrjen vizuale të personelit.
6. Në rastet kur i burgosuri nuk ka mjete financiare për të kryer biseda telefonike me familjarët, drejtoria e IEVP i mundëson komunikim online, por jo më shumë se katër herë në muaj.

7. Drejtori i institucionit, me vendim të prokurorit ose gjykatës, kufizon të drejtën e të burgosurit për biseda telefonike.
8. Nëse i burgosuri abuzon me rregullat për zhvillimin e bisedave telefonike, thirrja ndërpritet nga punonjësi mbikëqyrës.

Neni 73

Takimet e të burgosurve me shtetësi të huaj me përfaqësitë diplomatike

1. Të burgosurit me shtetësi të huaj i krijohen të gjitha lehtësitë e nevojshme për komunikimin me përfaqësuesit diplomatikë, ose konsullorë të shtetit përkatës.
2. Të burgosurit, shteti i të cilit nuk ka përfaqësi diplomatike në Republikën e Shqipërisë, refugjatëve, si dhe personave pa shtetësi, u krijohen të njëjtat lehtësira për të komunikuar me përfaqësuesit diplomatikë të shtetit që merr përsipër mbrojtjen e interesave të tyre, ose me autoritetet kombëtare, apo ndërkombëtare që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e interesave të këtyre personave.
3. Përfaqësuesit diplomatikë dhe konsullorë kanë të drejtë të zhvillojnë takime në çdo kohë me shtetasit e tyre të burgosur, me njoftimin paraprak të institucionit.

KREU IX

TAKIMET ME GJYQTARË, PROKURORË, AVOKATË DHE INSTITUCIONE TË TJERA

Neni 74

Takimet me prokurorë, avokatë ose oficerë të policisë gjyqësore

1. Gjyqtarët, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të autorizuar lejohen të takohen në dhomën e takimit në regjimin e brendshëm për të zhvilluar veprime procedurale me të burgosurit.
2. Avokatët lejohen të marrin takim me të burgosurit, kundrejt aktit të përfaqësimit brenda orarit zyrtar.
3. Takimet e gjyqtarit, prokurorit, oficerit të policisë gjyqësore, lejohen në çdo kohë.
4. Të burgosurit kanë të drejtë të zhvillojnë takime në çdo kohë me përfaqësuesin e tyre ligjor, me njoftimin paraprak të institucionit.

Neni 75

Takimet me Avokatin e Popullit

1. Avokati i Popullit takohet me të burgosurit, në çdo kohë, pa njoftimin paraprak të institucionit.
2. Takimi i të burgosurve me Avokatin e Popullit nuk mbikëqyret.

Neni 76

Takimet me noterët dhe punonjësit e gjendjes civile

1. Të burgosurit lejohen të takohen me noterin e zgjedhur për kryerjen e veprimeve ligjore brenda orarit zyrtar.
2. Të burgosurit shoqërohen në zyrën e gjendjes civile për lidhje martesë apo për aplikimin për kartë identiteti ose pasaportë ose çdo veprim të ligjshëm në kompetencë të kësaj zyre, brenda orarit zyrtar.

KREU X

REHABILITIMI, PËRGATITJA PËR LIRIM DHE RIINTEGRIM

Neni 77

Programet rehabilituese

1. Programet e rehabilitimit synojnë aftësimin social të të burgosurve përmes marrjes së njohurive të reja dhe zhvillimit të aftësive pro-sociale, me qëllim minimizimin e riskut të sigurisë dhe parandalimin e mundësive për recidivizëm.
2. Programet rehabilituese përfshijnë programet e aftësive për jetën, programe terapeutike për shëndetin mendor, programe të arsimimit, formimit profesional, punësimit etj.
3. Pjesëmarrja në programe rehabilituese bëhet pas një vlerësimi të kujdeshshëm të riskut dhe nevojave kriminogjene të të burgosurit.
4. Administrata zhvillon një vlerësim të kujdeshshëm për të përcaktuar nëse i burgosuri paraqet rrezik për dëmtimin e vetes, apo të burgosurve të tjerë, personave që punojnë në burg, ose që vizitojnë burgun, ose komunitetit, dhe mundësinë për t'u arratisur ose për të kryer një krim tjetër të rëndë ndërkohë që është me leje nga burgu, ose i liruar.
5. Vlerësimi fillestar i rrezikut dhe i nevojave duhet të kryhet nga një personel i trajnuar në mënyrë të përshtatshme dhe mundësisht të zhvillohet në një qendër vlerësimi.
6. Trajtimi i grupeve të veçanta të të burgosurve bëhet nga një personel i trajnuar për këto kategori.

Neni 78

Individualizimi i trajtimit

1. Personeli i shërbimit social vlerëson personalitetin e të burgosurve, me qëllim identifikimin e nevojave psikologjike e sociale, aftësinë dhe vullnetin e të burgosurës për punë e formim profesional. Në bazë të rezultatit të vëzhgimit dhe të të dhënave personale, familjare, shoqërore, të masës së dënimit, personeli i kujdesit social harton planin e ri-integrimit për çdo të burgosur dhe programin e individualizuar të trajtimit për grupe të veçanta, i cili përgatitet nga një grup specialistësh, i përbërë nga psikologë, punonjës socialë dhe edukatorë. Plani i ri-integrimit përfshin këshillim, terapi, edukim, arsimim, formim profesional, punësim, shërbim bibliotekar, si dhe çdo shërbim tjetër të nevojshëm.
2. Punonjësi i shërbimit social evidenton të dhënat e grumbulluara nga vëzhgimi, trajtimi individual, si dhe nga sjellja gjatë gjithë periudhës së burgimit, të përfshira në dosjen psiko-sociale të të burgosurit.
3. Punonjësi i shërbimit social diskuton me të burgosurin planin e ri-integrimit dhe programin e individualizuar dhe bën rivlerësimin dhe ndryshimin në përputhje me ecurinë e trajtimit.
4. Rëndësi e veçantë i kushtohet trajtimit psiko-social të të burgosurve të mitur, grup moshës 18 deri 21 vjeç, grave, personave me çrregullime të shëndetit mendor, të pasura ose të fituara gjatë burgimit, personave me aftësi të kufizuara, personave me orientim seksual të ndryshëm, personave me sëmundje kronike ose të varur nga droga, të moshuarve, personave të dënuar me dënime afatgjata, personave që i përkasin minoriteteve etnike ose gjuhësore, shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi.

5. Planifikimi individual për menaxhimin e dënimit afatgjatë të të burgosurit duhet të ketë si qëllim zhvillimin progresiv në sistemin e burgjeve.
6. Vëzhgimi, programimi dhe realizimi i trajtimit bëhen nga administrata e institucionit me anë të personelit të vet, në bashkëpunim me organet dhe institucionet shtetërore përkatëse.
7. Kontributi i organizatave jofitimprurëse dhe individëve të veçantë nxitet dhe mbështetet nga administrata në realizimin e programit të trajtimit.

Neni 79

Prindërimi në distancë

1. Prindërimi në distancë synon forcimin e marrëdhënieve me familjen dhe përgatitjen për ri-integrim me përqëndrim të veçantë tek të miturit dhe gratë.
2. Në institucion krijohen mjedise të veçanta, të përshtatura për zbatimin e këtij programi, ku të burgosurit shpenzojnë deri në 4 orë për takimet që realizojnë me fëmijët të moshës deri në 18 vjeç.
3. Prindërim në distancë me miratim të drejtorit të institucionit mund të realizojnë edhe familjarët e të burgosurve që janë të moshuar dhe me probleme shëndetësore.

Neni 80

Pjesëmarrja në aktivitete dhe veprimtari kulturore, çlodhëse e sportive

1. Procesi i edukimit përfshin edhe programe të trajtimit në grup të të burgosurve, duke u dhënë mundësi atyre të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të institucionit, të cilat i ndihmojnë të zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë, vetëbesimit, si dhe të nxisin interesin për arsimim, formim profesional, veprimtari kulturore, çlodhëse e sportive, punë etj.
2. Administrata bashkëpunon me institucionet e tjera, organizatat jofitimprurëse e ato fetare për organizimin e veprimtarive kulturore, krijuese dhe sportive, brenda dhe jashtë institucionit.
3. Institucioni organizon veprimtari me karakter social çdo muaj. Data dhe koha e aktiviteteve sociale përcaktohet nga Drejtori i institucionit. Ndjekja e këtyre aktiviteteve është e lirë. Të vetmet lojëra të lejuara janë lojërat që nuk vënë në rrezik rendin, rregullin dhe sigurinë në dhoma dhe në të gjithë institucionin. Aktivitetet sportive janë të lejuara vetëm në vendet për këtë qëllim.
4. Përdorimi i dhomave dhe ambienteve çlodhëse përcaktohet me urdhër të Drejtorit të institucionit.
5. Mbajtja e materialeve për punë artizanale realizohet vetëm me marrjen e lejes. Puna artizanale që rrezikon rregullin e sigurinë në institucion.
6. Zhvillimi i aktiviteteve sportive me kërkesë të të burgosurve, jashtë programit të institucionit bëhet vetëm me leje të Drejtorit të Institucionit.

Neni 81

Arsimimi

1. Të burgosurit që nuk e kanë përfunduar arsimin 9-vjeçar i krijohen kushte për përfundimin e tij, me anë të një programi të veçantë, të miratuar nga Ministria e Arsimit. Pjesëmarrja dhe ecuria e mirë e të burgosurit në një program mësimor shënohet si tregues i pozitiv në vlerësimin periodik apo me objekt.
2. Mësimdhënia realizohet nga mësues të miratuar nga Drejtoritë Rajonale Arsimore. Në përfundim, i burgosuri pajiset me dokumentin që vërteton përfundimin e arsimimit dhe rezultatet e tij, duke mos e cilësuar vendin e vuajtjes së dënimit.

3. I burgosuri nxitet të marrë pjesë për arsimimin në nivele më të larta brenda dhe jashtë institucionit. Për të burgosurit që studiojnë në nivelin 9-vjeçar dhe të mesëm, institucioni merr përsipër mbulimin e shpenzimeve për arsimim.

Neni 82

Kurset profesionale

1. Drejtoria e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale nxit dhe krijon kushtet për formimin profesional brenda dhe jashtë institucionit. Trajnimi në këto kurse realizohet nga profesionistë sipas Marrëveshjes së përbashkët me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financës.
2. Kujdes i veçantë i kushtohet formimit kulturor dhe profesional të të burgosurve me moshë nën 25 vjeç.
3. Të burgosurit që i përkasin minoriteteve etnike ose gjuhësore, që nuk e kuptojnë, ose zotërojnë gjuhën shqipe dhe të dënuarve të huaj u mundësohen materiale të shkruara në gjuhën e tyre, ose në një gjuhë që e kuptojnë më mirë.
4. I burgosuri nxitet për frekuentimin e kurseve të formimit profesional.

Neni 83

Puna e të burgosurve

1. Puna e kryer nga i burgosuri shpërblehet sipas parashikimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.602, datë 13.10.2021 “Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”.
2. I burgosuri ka të drejtën e një shpërblimi mujor për punën e tij. Shpërblimi për secilën kategori caktohet në vlerë të drejtë në proporcion me sasinë dhe cilësinë e punës së kryer sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.602, datë 13.10.2021 “Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”.
3. Punësimi i të burgosurit ka si qëllim të garantojë fitimin, ruajtjen dhe zhvillimin e aftësive për punë dhe njohuri profesionale, për riintegrim në shoqëri, pas përfundimit të kryerjes së dënimit.
4. Aktet ligjore dhe nënligjore që shërbejnë për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, mirëqënies sociale dhe kohëzgjatjen e punës, si dhe ato që rregullojnë marrëdhëniet e punës, me përjashtim të ushtrimit të së drejtës për grevë dhe pjesëmarrje në sindikata, zbatohen njëjloj edhe për të burgosurit.
5. Të burgosurit e angazhuar në punë i sigurohen materiale dhe pajisje sipas normave të caktuara, të cilat administrohen nga magazinieri i burgut. Për materiale që janë sende të ndaluara dhe të nevojshme për punën e tyre, administrimi bëhet nga specialisti i informacionit.
6. I burgosuri i cili është angazhuar në punë duhet të sillet në mënyrë të përgjegjshme dhe profesionale për punën që i ngarkohet, duke respektuar urdhrat që i jepen dhe është e detyruar të ruajë edhe të mirëmbajtje të gjithë bazën materiale që ka në ngarkim. Për çdo shkelje të rregullit të mësipërm, për humbjen dhe dëmtimin nga pakujdesia dhe me qëllim të mjeteve të punës, i burgosuri është detyruar ta zhdëmtojë atë.
7. Rregulla të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës dhe kohëzgjatjen e saj, janë përcaktuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.602, datë 13.10.2021 “Për përcaktimin e

rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj” dhe në urdhrin përkatës të DPB.

8. Personeli i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, nxit, motivon dhe mbështet të burgosurit për punësim dhe vetëpunësim, duke vlerësuar aftësitë profesionale të tyre.
9. Për rastet e punësimit jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, personeli kryen një vlerësim të detajuar të vendit të punës, kushteve materiale, pozicionit ku ndodhet qendra e punës, përbërjen e të punësuarve, rrisqe për sigurinë e publikut, gatishmërinë për të pranuar dhe mbështetur të burgosurin e punësuar, transportin, distancën e etj.

Neni 84

Plotësimi i nevojave fetare

1. Të burgosurit kanë të drejtë të marrin pjesë në aktivitete fetare si lutje, falje, festë etj., por nuk mund të drejtojnë këto aktivitete.
2. Drejtimi i faljeve, lutjeve dhe aktiviteteve fetare duhet të kryhet nga përfaqësues i Komiteteve Fetare, zyrtare i autorizuar prej tyre dhe i verifikuar nga ana e institucioneve të sigurisë.
3. Gjatë zhvillimit të aktiviteteve fetare si nën pikën 4 të këtij neni, nuk lejohet bashkimi i të dënuarve të sigurisë së lartë me të dënuar të niveleve të tjera të sigurisë dhe as të dënuar të identifikuar me sjellje të dhunshme dhe me rrezik për të tjerët.
4. Nëse në institucionin nuk ekziston ambient i veçantë për plotësimin e nevojave fetare të burgosurit ceremoninë fetare (lutjen) mund ta kryejë në dhomë.
5. Gjatë zhvillimit të aktiviteteve fetare nuk duhet të prishet rendi, disiplina dhe siguria e përgjithshme në institucionin korrektues, as të fyhet ndjenja fetare ose nacionale e të burgosurit.

Neni 85

Shërbimi bibliotekar

1. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale nxitet dhe inkurajohet leximi i librave, nëpërmjet funksionimit të shërbimit të bibliotekës.
2. Shërbimi i bibliotekës organizohet dhe mbikëqyret nga sektori i çështjeve shoqërore, i cili kujdeset për mirëmbajtjen dhe pasurimin e saj, si dhe shpërndarjen e literaturës.
3. Në përzgjedhjen e literaturës duhet të mbahet parasysh sigurimi sa më i mirë i nivelit shkencor, kulturor dhe artistik.
4. Favorizohet leximi pa kufizim i botimeve dhe përdorimi i sistemeve të tjera informative të bibliotekës së institucionit.
5. Biblioteka e institucionit duhet të ketë literaturë për të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarave, legjislacionin bazë penal, procedural penal dhe në fushën e trajtimit të të burgosurve.
6. Çdo i burgosur ka të drejtë të anëtarësohet në bibliotekë dhe tërheqja e librave bëhet nëpërmjet kartelave personale të tyre.
7. Në bibliotekë realizohet leximi i librave dhe i shtypit të përditshëm nga të burgosurit.
8. Çdo i burgosur mund të tërheqë 1 deri në 3 libra njëherësh.
9. Koha e kthimit të librave është deri në 2 (dy) javë nga dita e marrjes.
10. Lexuesi mund të paraqitet në bibliotekë për të kërkuar shtyrje të afatit.
11. Libri që merret nga biblioteka duhet të mbahet me kujdes. Përpara marrjes së librit në dorëzim, lexuesi këshillohet ta kontrollojë atë. Në rast dëmtimi të librit, ose humbje, libri do të zhdëmtohet nga lexuesi që e ka në ngarkim.
12. Nuk lejohet shkëmbimi i librave midis të burgosurve, si dhe të marrin librat në vendin e tyre të punës.

13. Në raste lirimesh, transferimesh, i burgosuri duhet ta dorëzojë personalisht librin në bibliotekë përpara momentit të largimit nga institucioni.

Neni 86

Përgatitja për liri dhe riintegrim

1. Plani e përgatitjes për liri (para-lirimit) hartohen jo më vonë se 6 muaj përpara lirimit të të burgosurit.
2. Për të gjithë të burgosurit e liruar duhet të ketë një plan të veçantë. Ky plan merr parasysh shkallën e nevojave dhe rreziqeve të tyre që janë adresuar gjatë kohës në burg, si dhe rekomandimet për ndërhyrje të ardhshme, jep sugjerime për parandalimin e kryerjes së veprave të tjera penale pas lirimit nga burg, si dhe nevojën për t'i referuar në shërbime të komunitetit apo në agjensi mbështetëse.
3. Bashkëpunimi me Institucione dhe agjensive të ndryshme përbën një element kyç për riintegrimin e sigurtë dhe të suksesshëm të çdo të burgosuri në shoqëri.

Neni 87

Komisioni i vlerësimit të sjelljes

1. Komisioni i vlerësimit të sjelljes së të burgosurve ngrihet me urdhër të Drejtorit të institucionit.
2. Komisioni i vlerësimit të sjelljes kryesohet nga përgjegjësi i sektorit ligjor dhe përbëhet nga katër anëtarë:
 - a. Përgjegjësi i sektorit të çështjeve shoqërore;
 - b. Specialisti i sektorit të çështjeve shoqërore të grupit;
 - c. Përgjegjësi i sektorit të sigurisë;
 - d. Specialisti i regjimit të brendshëm.

Neni 88

Vlerësimi i sjelljes së të burgosurve

1. Komisioni i vlerësimit të sjelljes, harton vlerësimin e sjelljes për çdo të burgosur, si më poshtë:
 - a. çdo 6 muaj dhe vlerësimi protokollohet dhe administrohet në dosjen psiko-sociale dhe në dosjen penale.
 - b. për seancat gjyqësore me objekt uljen e dënimit, pasqyrohen të gjitha masat disiplinore të dhëna ndaj tij/saj për vitin e fundit të vuajtjes së dënimit.
 - c. për seancat gjyqësore me objekt lirimin me kusht ose ndryshimin e klasifikimit të sigurisë, pasqyrohen të gjitha masat disiplinore të dhëna ndaj të dënuarit gjatë 2 viteve të fundit të vuajtjes së dënimit.
2. Në çdo rast transferimi nga një institucion në tjetrin, shoqërohet me vlerësimin e sjelljes, i cili administrohet në dosjen personale.
3. Vlerësimi i sjelljes për transferim përfshin periudhën nga vlerësimi 6 mujor i fundit.

KREU XI

DISIPLINA E TË BURGOSURVE

Neni 89

Rregullat e sjelljes

1. Të burgosurit gjatë gjithë kohës së vuajtjes së dënimit duket të respektojnë rregullat dhe detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe në programin e trajtimit të tyre, rendit dhe qetësinë në institucion si dhe të sillen me korrektësi dhe përgjegjshmëri.
2. Të burgosurit duhet të zbatojnë me vetëdije dhe në kohë, urdhrat e dhëna nga punonjësit e institucionit. Kur një nga punonjësit e institucionit konstaton shkeljen e rregullave, rendit dhe qetësisë në institucion, harton raportin e incidentit, i cili duhet të përmbajë hollësisht faktet dhe rrethanat si dhe të burgosurin përgjegjës për këtë shkelje.

Neni 90

Sjellja në raport me punonjësit e burgut

1. Të burgosurit në raport me punonjësit e burgut duhet të sillen në mënyrë të sjellshme dhe me respekt të dyanshëm.
2. Në rast se një punonjës i institucionit hyn në dhomë ku ndodhen persona të burgosur, ata duhet të mbajnë një qëndrim të përshtatshëm.
3. Kur një punonjës i institucionit hyn në ambientin e punës së të burgosurve, puna në të nuk duhet të ndërpritet.

Neni 91

Sjellja e të burgosurve në raport me njëri-tjetrin

1. Të burgosurit duhet të tregojnë tolerancë dhe respekt reciprok me njëri-tjetrin. Ata duhet të përmbahen nga ndonjë akt dhune, grindje, fyerje apo mungesë të mirësjelljes.
2. Nëse një i burgosur, ndihet i fyer, apo ofenduar nga një i burgosur tjetër, ai/ajo nuk duhet të kërkojë shlyerje personalisht, por është i/e detyruar të raportojë këtë incident tek punonjësi më i afërt i institucionit.
3. I burgosuri nuk lejohet të bëjë tregti me punonjësit e institucionit, apo të burgosurit e tjerë që ndodhen në institucion. Kjo nuk nënkupton vetëm blerjen apo shkëmbimin e sendeve, por edhe dhënien, apo pranimin e tyre si dhurata, dhënien hua apo ndonjë formë tjetër të dhënies apo pranimit të sendeve.

Neni 92

Sjellja e të burgosurve në institucion

1. Gjatë kontrollit të prezencës, apo gjatë rreshtimit për të lëvizur apo për t'u kthyer nga dhe për tek vendi i punës, aktivitete, shërbimi i ushqimit apo të ngjashme, të burgosurit duhet të vendosen me rregull.
2. Prona e institucionit duhet të trajtohet me kujdes dhe nuk duhet të ndryshojë destinacion pa leje. Dëmtimi i kësaj prone duhet të raportohet tek punonjësi më i afërt i institucionit në detyrë. Të burgosurit që shkaktojnë dëm material ndaj pronës së institucionit, ose të burgosurve të tjerë janë të detyruar ta dëmshpërblejnë atë.
3. Në mënyrë të veçantë është e ndaluar:
 - a. Krijimi i zhurmave të papërshtatshme dhe shqetësuese, veçanërisht thirrja apo, të kënduarit me zë të lartë, fishkëllimat, apo goditjet;
 - b. Përdorimi i paautorizuar, apo i papërshtatshëm i ndonjë pajisje elektrike duke përfshirë radiot, apo televizorët;
 - c. Hedhja apo zbrazja e sendeve nga ambienti i burgut;
 - d. Përdorimi i papërshtatshëm i objekteve dhe inventarit të dhomës;

- e. Shkaktimi i ndotjes së pajisjeve të dhomës, mureve, dyshemesë, korridoreve, tavanit, apo shkarravitja në to;
- f. Ngulja apo ngjitja e fotografive, apo vizatimeve në pajisjet e dhomës dhe muret e dhomës, me përjashtim të vendeve të parashikuara për këtë qëllim. Në çdo rast këto veprime janë të ndaluara në muret e jashtme;
- g. Mbulimi i dritareve të dhomës, dyerve, i dritares së kontrollit, apo i mureve të jashtme;
- h. Ushqyerja e kafshëve të egra, shtëpiake apo jo-shtëpiake;
- i. Thirrja e punonjësit të institucionit duhet të bëhet vetëm për raste të urgjencës, apo për arsye që detyrojnë, apo kërkojnë veprim të menjëhershëm.
- j. Dyert e dhomave, apo të ambienteve të përbashkëta si rregull duhet të rrinë të mbyllura;
- k. I burgosuri duhet të shmangë çdo lloj shqetësimi gjatë pushimit të natës;
- l. Objektet që të burgosurit lejohen të mbajnë pas pranimit në institucion, apo objektet që merren më vonë duhet të mbahen në mënyrë të tillë që nuk rrezikon rregullin dhe sigurinë.

Neni 93

Pirja e duhanit dhe konsumimi i substancave të palejuara

1. Pirja e duhanit është e ndaluar në shtrat, gjatë kontrollit të prezencës, gjatë përgatitjes për të lëvizur, apo për t'u kthyer, në shkallë, gjatë frekuentimit të aktiviteteve, vizitave të mjekut, në dhomat e pritjes, në infermieri dhe në ambientet e punës, në dhomat e çlodhjes dhe të ushtrimit fizik si dhe kur i burgosuri lëviz për jashtë burgut, apo kur transferohet.
2. Ndalesa të mëtejshme për pirjen e duhanit mund të caktohen nga Drejtori i Institucionit.
3. Konsumimi i alkoolit dhe i substancave narkotike është i ndaluar. Testet për drogën janë të lejueshme.

Neni 94

Përgjegjësia për shkaktimin e dëmit

1. Në rastin e dëmtimit të një sendi të luajtshëm ose të paluajtshëm, pronë e institucionit, Drejtori i Institucionit duhet të përcaktojë dëmtuesin dhe masën e dëmit dhe pasi dëgjon të burgosurin përgjegjës, e njofton atë për vlerën e dëmit, duke e ftuar që ta shlyejë atë vullnetarisht. Në rast të kundërt, Drejtori i Institucionit ngre komisionin e vlerësimit të dëmit dhe urdhëron e mbajtjen e vlerës monetare nga numri i llogarisë personale të të burgosurit. Nëse vlera nuk gjendet në llogarinë personale, atëherë thirren familjarët e tyre për të bërë zhdëmtimin kundrejt dokumentacionit ligjor.
2. Në rast dëmtimi të sendeve të të burgosurve nga njëri- tjetri, Drejtori i institucionit ndërmjetëson për zgjidhjen me mirëkuptim të çështjes. Dëmshpërblimi vullnetar përbën rrethanë lehtësuese kur gjatë shqyrtimit të masës disiplinore, vendoset për masën disiplinore përkatëse. Në rast të kundërt, ndiqet procedura e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni.

Neni 95

Klasifikimi i shkeljeve disiplinore

1. Shkeljet disiplinore klasifikohen në shkelje të lehta, shkelje të rënda dhe shumë të rënda.
2. Konsiderohen shkelje të lehta disiplinore:
 - a. neglizhenca në kryerjen e pastrimit personal, të dhomës apo të mjediseve të përbashkëta;
 - b. simulimi i sëmundjes
3. Konsiderohen shkelje të rënda disiplinore:
 - a. përdorimi i fjalëve të pahijshme e fyese ndaj të burgosurve të tjerë, apo personelit të institucionit;

- b. kryerja e veprimeve, ose akteve me qëllime përfitimi;
- c. moszbatimi i detyrimeve dhe urdhrave, ose vonimi i pajustificuar i zbatimit të tyre.
4. Konsiderohen shkelje shumë të rënda disiplinore:
 - a. organizimi, pjesëmarrja dhe nxitja e veprimtarive që cenojnë masat e sigurisë në IEVP;
 - b. kundërshtimi me dhunë ndaj punonjësve të IEVP-së;
 - c. ushtrimi i dhunës fizike ose psikike ndaj të burgosurve të tjerë;
 - d. përgatitja dhe përpjekja për t'u larguar nga IEVP-ja ose gjatë shoqërimit të tij;
 - e. përvetësimi ose dëmtimi me dashje i pasurisë së IEVP-së ose të burgosurve të tjerë;
 - f. dhuna verbale dhe sjellja agresive ndaj të burgosurve të tjerë;
 - g. mbajtja, përdorimi dhe qarkullimi i sendeve të ndaluara, kur nuk përbën vepër penale;
 - h. përdorimi i lëndëve narkotike dhe pijeve alkoolike;
 - i. shkelja e afatit të kthimit në IEVP pas lejes, pa arsye objektive të vërtetuara.
5. Ndaj të burgosurit nuk mund të fillojë procedimi disiplinor në rastet kur sjelljet, veprimet apo mosveprimet e tyre nuk përbëjnë shkelje disiplinore.
6. Masa disiplinore caktohet në përputhje me llojin dhe rëndësinë e shkeljes, qëndrimin e të burgosurit, si dhe vlerësimin e sjelljes.
7. Masat disiplinore zbatohen duke respektuar personalitetin dhe dinjitetin e të burgosurit.
8. Masat disiplinore duhet të përdoren si mjet i fundit i disiplinimit të sjelljes. Në rastet kur është e mundur, autoritetet e institucionit përdorin ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve mes të burgosurve, ose mes tyre dhe personelit të institucionit.
9. Masat disiplinore zbatohen në mënyrë që të nxisin ndjenjën e përgjegjësisë dhe aftësinë e vetëkontrollit të të burgosurve.
10. Për personat e diagnostikuar me çrregullime të shëndetit mendor, personat që kanë pasur përvoja të dhunës fizike, psikologjike ose të abuzimit seksual, zbatohet një regjim disiplinor lehtësues në përputhje me nevojat e tyre.

Neni 96

Masat parandaluese

1. Drejtori i institucionit mund të urdhërojë veçimin e të burgosurit vetëm për shkelje shumë të rënda, duke e vendosur në mjediset e veçimit, deri në mbledhjen e komisionit disiplinor të institucionit.
2. Komisioni vendos për masën disiplinore me qëllim garantimin e masave të sigurisë në institucion dhe për të parandaluar dëmtime apo pasoja, që mund të vijnë nga sjellja apo veprimet e të burgosurve, si dhe për të demonstruar zbatimin e regjimit dhe rregullave të brendshme në institucion.
3. Në rast se shoqërimi i të burgosurit në dhomat e veçimit është kryer duke përdorur forcën, personeli duhet ta raportojë këtë tek drejtori i institucionit në formular standard dhe e mban të burgosurin në mbikëqyrje.
4. Në rastet e kryerjes së shkeljeve të rënda ose të lehta, masa disiplinore ekzekutohet pas vendimit nga komisioni disiplinor.

Neni 97

Masat disiplinore

1. Për shkeljet disiplinore zbatohen këto masa:
 - a. këshillim individual;
 - b. përjashtim nga veprimtari të përbashkëta deri në 10 ditë;

- c. përjashtim nga ajrosja në grup deri në 10 ditë;
- d. përjashtim nga veprimtaritë e përbashkëta deri në 14 ditë;
2. Për shkeljet disiplinore shumë të rënda zbatohen këto masa:
 - a. përjashtimi nga të gjitha veprimtaritë e përbashkëta deri në 14 ditë;
3. Për shkeljet disiplinore të rënda zbatohen këto masa:
 - a. përjashtim nga ajrosja në grup deri në 10 ditë;
 - b. përjashtim nga veprimtaritë e përbashkëta deri në 10 ditë.
4. Për shkeljet disiplinore të lehta zbatohen këto masa:
 - a. këshillim individual;
5. Ndalohet dënimi dy herë për të njëjtën shkelje, për të cilën është shprehur më parë me vendim organi kompetent disiplinor.
6. I burgosuri ndaj të cilës është dhënë një masë disiplinore, në përputhje me shkronjat “b” dhe “d”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset në dhomat e veçimit të cilat duhet të respektojnë standardet minimale që zbatohen për qëndrimin e të dënuarve, deri në përfundim të kohëzgjatjes së masës disiplinore.
7. Masat e parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “d”, të pikës 1, jepen deri në gjysmën e kohës së parashikuar në rastet e të burgosurve gra. Ndaj të të burgosurve shtatzëna ose që kanë fëmijën nën përkujdesje në institucion, zbatohet vetëm masa disiplinore e parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni.
8. Ndaj të burgosurve me aftësi ndryshe fizike ose çrregullime të shëndeti mendor masat disiplinore të parashikuara në shkronjat “b” dhe “d” të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të jepen nëse ndikojnë në përkeqësimin e gjendjes së tyre, bazuar në raportin mjekësor të hartuar nga mjeku i institucionit.
9. Masat disiplinore të përjashtimit nga veprimtaritë e përbashkëta të parashikuara në shkronja “b” dhe “d” të pikës 1 të këtij neni, nuk mund fillojnë të zbatohen pa patur një raport paraprak, të lëshuar nga mjeku që vërteton gjendjen fizike dhe mendore të të burgosurit.
10. Zbatimi i masës disiplinore të përjashtimit nga veprimtaritë e përbashkëta i nënshtrohet kontrollit të përditshëm mjekësor. Regjimi gjatë zbatimit të kësaj mase disiplinore duhet të garantojë të paktën 1 herë kontakte me anëtarët e familjes gjatë periudhës së zbatimit të kësaj mase disiplinore dhe të paktën dy orë ajrim çdo ditë nëse e lejojnë kushtet atmosferike.
11. Masat disiplinore, llojet e tyre dhe kufijtë e zbatimit të tyre ndaj të burgosurve të mitur parashikohen në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur. Rregullat e posaçme për zbatimin e tyre parashikohen në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.
12. Masat disiplinore administrohen në dosjen personale të të dënuarit dhe shërbejnë si referencë gjatë vlerësimit periodik apo me objekt, gjithnjë brenda afatit të parashkrimit.
13. Masa disiplinore parashkruhet, sipas përcaktimeve të ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve.

Neni 98

Komisioni Disiplinor dhe procedimi disiplinor

1. Në rastin e një shkeljeje disiplinore personeli i institucionit dokumenton shkeljen e ndodhur, nëpërmjet raportit të incidentit, që administrohet në sekretari dhe i vihet në dispozicion Drejtorit të Institucionit, i cili urdhëron fillimin e procedurave disiplinore.
2. Në rastet e shkeljeve shumë të rënda dhe të rënda, masa vendoset nga komisioni disiplinor i institucionit.

3. Masa disiplinore e këshillimit jepet nga Drejtori i institucionit pas sqarimit të rrethanave, komunikimit me të burgosurin dhe pasi këtij të fundit i garantohet e drejta e mbrojtjes.
4. Komisioni disiplinor përbëhet nga:
 - a. Drejtori i institucionit në cilësinë e kryetarit,
 - b. Përgjegjësi i sektorit ligjor në cilësinë e anëtarit,
 - c. Përgjegjësi i sektorit të sigurisë në cilësinë e anëtarit,
 - d. Përgjegjësi i sektorit të kujdesit social në cilësinë e anëtarit
 - e. Specialisti i sektorit të kujdesit social që trajton të burgosurin në cilësinë e anëtarit
5. Mjeku harton në çdo rast një raport mjekësor, ku shprehet mbi gjendjen shëndetësore të të burgosurit. Ky raport mjekësor i shërben komisionit disiplinor për përcaktimin e masës disiplinore.
6. Komisioni ngrihet dhe funksionon me urdhër të Drejtorit të institucionit, i cili e mbledh atë jo më vonë se 2 (ditë) pune nga momenti i kryerjes së shkeljes.
7. Gjatë mbledhjes së komisionit disiplinor, dëgjohen pretendimet e të burgosurit. Të burgosurit i lejohet mbrojtja me avokat. Për të burgosurin me shtetësi të huaj sigurohet ndihma e një përkthyesi.
8. Komisioni disiplinor merr vendimin përkatës me shumicë votash, i cili i komunikohet të burgosurit dhe i jepet një kopje e tij. Vendimi mund të ankimohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
9. Masat disiplinore evidentohen në regjistrin përkatës dhe në dosjen personale dhe psiko-sociale të të burgosurit.

Neni 99

Procedura e dhënies së masave disiplinore

1. Komisioni disiplinor merr vendim për dhënien e masës disiplinore pasi ka dëgjuar të burgosurin ndaj të cilit po zhvillohet një procedurë një disiplinore.
2. Njoftimi i të burgosurit, ose refuzimi i tij për t'u shprehur përpara komisionit vërtetohet kundrejt nënshkrimit dhe në rastet e kundërshtimit të tij për të firmosur, me nënshkrimin e dy personave të tjerë nga personeli, që nuk janë të përfshirë në ngjarjen.
3. I burgosuri mund të mbrohet vetë, ose nga mbrojtësi i tij, kur e çmon të nevojshme. Gjithashtu, atij i garantohet e drejta për të thirrur dëshmitarë në emër të tyre, ose për të kundërshtuar provat ndaj tyre, si dhe garantohet kohë e mjaftueshme dhe lehtësi për të përgatitur mbrojtjen.
4. Të burgosurit me shtetësi të huaj gëzojnë të drejtën të kenë përkthyes, nëse nuk mund të kuptojnë, ose flasin gjuhën shqipe.
5. Komisioni disiplinor i dorëzon të burgosurit një kopje të vendimit për marrjen e masës disiplinore.
6. Masa disiplinore nuk mund të jepet nëse kanë kaluar 30 ditë nga konstatimi i saj.

Neni 100

Ankimimi kundër vendimit të komisionit disiplinor

1. I burgosuri ka të drejtë të animojë masën disiplinore pranë komisionit të apelit të masave disiplinore në D.P.B, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga vënia e tij në dijeni.
2. Komisioni i apelit vendos lënien në fuqi, shfuqizimin ose kthimin për rishqyrtim, të vendimit të komisionit disiplinor në IEVP brenda 14 ditëve nga marrja e ankimit.

Neni 101

Procedurat disiplinore për të mitur

Procedurat disiplinore, masat, ndalimet, mënyra si ekzekutohen masat disiplinore për të mitur, bazohen në Kodin e Drejtësisë për të Mitur, miratuar me Ligj Nr.37/2017

KREU XII

LEJËT SHPËRBLYESE DHE TË VEÇANTA

Neni 102

Shqyrtimi i kërkesave për leje shpërblyese apo të veçanta

1. Drejtori i institucionit është autoriteti përgjegjës për dhënien e lejeve shpërblyese dhe të veçanta për të dënuarit e sigurisë së zakonshme.
2. Miratimi, apo refuzimi i kërkesave për leje shpërblyese, apo të veçanta duhet të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara në nenet 72 dhe 73, të ligjit Nr.81, datë 25.06.2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, me kërkesat e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, si dhe me udhëzimin e Ministrit të Drejtësisë.
3. Sektori ligjor në çdo fillim viti dërgon në DPB planifikimin vjetor paraprak të lejëve shpërblyese të të dënuarve që plotësojnë kriteret ligjore, të ndarë sipas një grafiku të përcaktuar.
4. Kërkesat për leje të veçanta dhe shpërblyese i drejtohen Drejtorit të Institucionit dhe regjistrohen në regjistrin e lejeve të të dënuarave.

Neni 103

Lejet shpërblyese

1. Të dënuarit, të cilat respektojnë rregullat e disiplinës rregullore, dhe janë të motivuar për të marrë pjesë në programet rehabilituese e të ri-integrimit dhe nuk paraqesin rrezikshmëri shoqërore, kanë të drejtë të marrin leje shpërblyese, deri në 20 ditë në vit, të ndarë në çdo tre mujor.
2. Për të dënuarit e mitur kohëzgjatja e lejeve shpërblyese në total, përcaktohet në përputhje me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.
3. Planifikimi i lejeve shpërblyese bëhet sipas një grafiku të përcaktuar në fillim të vitit. Me prioritet planifikohen për leje shpërblyese të dënuarit e kategorizuar në burgun e hapur dhe në sigurinë e ulët.
4. Brenda 7 ditëve nga marrja e kërkesës për leje shpërblyese, Drejtori i institucionit vendos miratimin ose jo të saj, duke u bazuar në planifikimin vjetor dhe raportet e vlerësimit të përgjegjësve të sektorit të sigurisë, sektorit të çështjeve shoqërore dhe sektorit ligjor. Në raportet e vlerësimit përfshihen respektimi i kërkesave ligjore, vlerësimi i sjelljes së të dënuarit, vlerësimi i riskut, pjesëmarrje tij në programe rehabilituese dhe ri-integruese, ose në programe të tjera brenda institucionit, besueshmëria që paraqet i dënuari për kthimin e tij në institucion, ekzistenca ose jo e masave disiplinore, marrëdhënia me familjen, si dhe çdo aspekt tjetër që ka të bëjë me profilin e të dënuarit. Për miratimin e lejes duhet vlerësimi pozitiv i të gjithë sektorëve.
5. Leja shpërblyese u jepet:
 - a. të dënuarve deri në 3 vjet burgim, pasi të kenë vuajtur jo më pak se 1/4 e dënimit;

- b. të dënuarve nga 3 deri në 10 vjet burgim, pasi të kenë vuajtur jo më pak se 1/2 e dënimit;
 - c. të dënuarve mbi 10 vjet burgim, pasi t'u ketë mbetur për të vuajtur më pak se 5 vjet heqje lirie.
6. Në çdo rast, duhet të kenë kaluar të paktën 3 muaj, nga miratimi i lejes shpërblyese të fundit.
 7. Të dënuarit të cilët dënohen gjatë vuajtjes së dënimit për një vepër penale të kryer brenda në IEVP, nuk trajtohen me leje shpërblyese.
 8. Për të dënuarit të cilët kanë një vendim bashkim dënimesh, përlllogaritja e afatit për të përfutur leje shpërblyese i referohet masës së dënimit të bashkuar, sipas pikës 5 të këtij neni.
 9. Në rast refuzimi të dhënies së lejes, i dënuari në seksionin e sigurisë së zakonshme apo të sigurisë së ulët ose përfaqësuesi i saj ligjor, ka të drejtë të bëjë ankim brenda 5 ditëve pranë Ministrit të Drejtësisë, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe më pas ka të drejtë të ankohet në gjykatë, e cila vendos për kërkesën për leje. I dënuari në seksionin e sigurisë së lartë ose përfaqësuesi ligjor i saj, mund të paraqesin ankim në gjykatën kompetente brenda 5 ditëve nga marrja dijeni.
 10. Procedurat e dhënies së lejeve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 104

Lejet e veçanta

1. Drejtori i institucionit është personi përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës së të burgosurit për lejë të veçantë sipas procedurës së mëposhtme:
 - a. kërkesa e të burgosurit duhet të jetë e argumentuar dhe e shoqëruar nga dokumentacioni përkatës. Në raste sëmundjesh të rënda, të cilat rrezikojnë jetën e anëtarëve të familjes së të burgosurit, kërkesa duhet të shoqërohet me raportin mjekësor të familjarit të sëmurë ku vërtetohet gjendja e rëndë shëndetësore e tij.
 - b. Në rastet e ngjarjeve të rëndësishme familjare si vdekje, lindje apo martesë, kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentin zyrtar që provon vdekjen, lindjen apo martesën. Me anëtar të familjes së të burgosurit nënkuptohen nëna, babai, fëmijët, gjyshërit, motra, vëllai, bashkëshorti/ja, ose në rastet kur martohet vetë, si dhe në rastet e dhënies së provimeve nga ana e tij/saj.
 - c. pas marrjes së kërkesës dhe dokumentacionit përkatës nga i burgosuri, Drejtori i Institucionit, urdhëron brenda ditës së marrjes së kërkesës, përgjegjësin e sektorit ligjor, përgjegjësin e sektorit të sigurisë dhe përgjegjësin e sektorit të çështjeve shoqërore, për shqyrtimin dhe përgatitjen e dokumentacionit që do të shërbejë si bazë e miratimit apo refuzimit të lejes së veçantë.
 - d. lidhur me lejet e veçanta për arsye shëndetësore të anëtarëve të familjes së të burgosurit, dokumenti mjekësor që përcakton sëmundjen e rëndë e cila rrezikon jetën e anëtarit të familjes së të burgosurit shoqëron kërkesën për lejë të veçantë, vlerësohet edhe nga përgjegjësi i sektorit të shëndetësisë në institucion, ose në mungesë të tij nga mjeku i institucionit, i cili bën akt verifikimin e epikrizës mjekësore duke kontrolluar të gjitha elementet që provojnë vërtetësinë e saj, shprehet me shkrim për shkallën e rrezikshmërisë së sëmundjes së anëtarit të familjes së të burgosurit kontrollon nëpërmjet komunikimit telefonik me qendrën spitalore, ku është shtruar i sëmuri, ose me mjeket që kanë nënshkruar epikrizën. Akt verifikimi i mjekut dhe mendimi me shkrim i tij i bashkëlidhen raportit të përbashkët të tre sektorëve të përcaktuar në paragrafin “b”, të pikës 1, të këtij neni.
 - e. përgjegjësi i sektorit të sigurisë dhe përgjegjësi i sektorit të çështjeve shoqërore përgatisin, brenda ditës nga data e marrjes së urdhrit, një raport të përbashkët, të hollësishëm, i cili shpjegon dhe dokumenton lidhjen e ngushtë familjare të të burgosurës me personin e sëmurë rëndë, të vdekur,

të lindur ose të martuar, kohëzgjatjen e vuajtjes së dënimit, lejet e kryera më parë, respektimin e rregullores së brendshme të institucionit, rrezikshmërinë dhe besueshmërinë që paraqet i burgosuri, përmes qëndrimit të saj jashtë institucionit, pjesëmarrjen në programe rehabilituese, që zhvillohen në institucion, çdo të dhënë tjetër që ka të bëjë me të burgosurën, si dhe propozimin e argumentuar të miratimit, apo të refuzimit të lejes së veçantë dhe të ditëve që duhet të marrë i burgosuri, si leje e veçantë.

- f. raporti, propozimi dhe dokumentacioni i paraqiten brenda ditës Drejtorit të Institucionit, i cili e shqyrton dhe jep miratimin, apo refuzimin e motivuar të lejes së veçantë.
 - g. leja e veçantë mund të miratohet nga Drejtori i institucionit, vetëm pasi të ketë marrë mendimin pozitiv të tre sektorëve, hartues të raportit, në favor të miratimit të saj nga përgjegjësi i sektorit ligjor, përgjegjësi i sektorit të sigurisë dhe përgjegjësi i shërbimit social.
2. Drejtori i Institucionit që jep lejën, duhet të përcaktojë mënyrën, kushtet, mjetet e shoqërimit të të burgosurit, me forca të policisë së burgjeve dhe numrin e tyre. Leja e veçantë për të dënuarit jepet me kohëzgjatje deri në 48 orë, dhe bëhet me shoqërim vetëm gjatë ditës.
 3. Leja e veçantë mund të zgjatet me kërkesë të të dënuarit edhe 24 orë të tjera me miratimin e Drejtorit të Institucionit, vetëm për rastet e sëmundjeve të rënda, kundrejt dokumentacionit ligjor të paraqitur në institucion.
 4. Leja e veçantë pa shoqërim, mund të miratohet vetëm për të dënuarit të cilët janë trajtuar më parë me lejë shpërblyese.
 5. Lejët e veçanta për të paraburgosurit jepen sipas kërkesave të këtij neni, me miratimin e prokurorit dhe me shoqërim.

Neni 105

Lejët e veçanta për të paraburgosurit

1. Të paraburgosurit nuk përfitojnë lejë shpërblyese.
2. Me miratimin paraprak të Prokurorit dhe të Drejtorit të institucionit, të paraburgosurit mund t'i jepet leje e veçantë për:
 - a. lindje të fëmijës së të paraburgosurit;
 - b. martesë e fëmijës, vëllait, motrës, apo prindit të të paraburgosurit;
 - c. vdekje e fëmijës, bashkëshortit/bashkëshortes, gjyshërit, vëllait, motrës apo prindit të të paraburgosurit, ose të bashkëshortit/es të tij/saj.
 - d. në rast të sëmundjeve të rënda, të cilat rrezikojnë jetën e anëtarëve të familjes, të vërtetuar me raport mjekësor
 - e. dhënia e provimeve të vetë të paraburgosurit.
3. Vërtetimi i fakteve juridike dhe identifikimi i personave të mësipërm bëhen në bazë të dokumenteve të lëshuara për këto raste nga institucionet përkatëse.

Neni 106

Leja për të miturin e dënuar me burgim

1. I mituri i dënuar me burgim ka të drejtë të marrë leje të shkurtër nga vendi i vuajtjes së dënimit tre herë në vit. Kohëzgjatja e kësaj leje nuk i kalon 15 ditë. Në këtë kohë përfshihet edhe koha e nevojshme për udhëtim në familjen e tij ose në destinacion.
2. I mituri i dënuar me burgim ka të drejtë të marrë një leje të shkurtër nga vendi i vuajtjes së dënimit në rast se:

- a. ka kryer jo më pak se një të tretën e dënimit, nëse është dënuar me burgim deri në 3 vjet;
- b. ka kryer jo më pak se gjysmën e dënimit, nëse është dënuar me burgim deri në 8 vjet;
- c. ka kryer jo më pak se dy të tretat e dënimit, nëse është dënuar me burgim mbi 8 vjet.

KREU XIII

TRAJTIMI I KATEGORIVE TË TJERA

Neni 107

Trajtimi i të burgosurve me shtetësi të huaj

1. Të burgosurit shtetas i huaj i mundësohet njoftimi i familjes, përfaqësuesit ligjor, përfaqësuesit konsullor, ose organizatës kompetente që vepron në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.
2. Të burgosurve shtetas të huaj, që nuk kanë përfaqësi diplomatike, ose konsullore në vend, ose personave pa shtetësi, u mundësohet komunikimi me përfaqësitë diplomatike të shtetit që mbron interesat e tyre ose me autoritetin kombëtar ose ndërkombëtar, detyra e të cilit është mbrojtja e interesave të këtyre personave.

Neni 108

Veprimet në rast vdekje të të burgosurve të huaj

1. Në rastin e vdekjes së të burgosurve të huaj, njoftimi i vdekjes bëhet nëpërmjet Ministrisë së Jashtme, përfaqësuesve diplomatikë ose konsullorë në Republikën e Shqipërisë, të shtetit të cilit ajo i përket, përfaqësuesve të shtetit që merr në mbrojtje interesat e tyre, ose nëpërmjet autoriteteve kombëtare apo ndërkombëtare, që kanë për qëllim të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e interesave të këtyre personave.
2. Në rastin e të burgosurve të huaj që nuk u dihet vendbanimi, familjarët ose personat e tjerë të caktuar më parë nga ai, njoftimi i tyre bëhet të paktën në dy media kombëtare për një periudhë 10 ditore.

Neni 109

Trajtimi i të burgosurve të minoriteteve etnike ose gjuhësore

Të burgosurit që i përkasin minoriteteve etnike ose gjuhësore, të huaja ose persona pa shtetësi, pajisen me informacion me gojë dhe me shkrim, në gjuhën që ata kuptojnë, për të drejtat dhe detyrimet e tyre në institucion, si dhe nëse është e mundur ju ofrohen kurse të gjuhës shqipe.

Neni 110

Trajtimi i të burgosurve me aftësi të kufizuar

1. Të burgosurve me aftësi të kufizuara u ofrohet trajtim dhe sigurim shëndetësor, në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme.
2. Shërbimi shëndetësor i të burgosurve me aftësi të kufizuar u ofrohet me të njëjtën cilësi dhe standard të shërbimeve shëndetësore në strukturat e shëndetit publik dhe pa pagesë.

Neni 111

Trajtimi i të burgosurve me HIV/AIDS

Për të burgosurit me HIV/AIDS garantohej trajtim specifik falas dhe ofrohet këshillim për HIV/AIDS-in, me qëllim përgatitjen e të dënuarit për përballimin e pasojave të mundshme të stresit dhe për t'i ndihmuar në marrjen e vendimeve bazuar në informacionet për HIV/AIDS-in. Këshillimi përfshin informimin, edukimin dhe mbështetjen psiko-sociale, të cilat i mundësojnë personit me HIV/AIDS të jetojë dhe parandalojë transmetimin e virusit HIV/AIDS.

KREU XIV

NJOFTIM PËR VDEKJET, SËMUNDJET E TË BURGOSURVE

Neni 112

Njoftimet për rastet e sëmundjeve dhe vdekjeve

1. Në rastet e sëmundjeve të rënda, dëmtimeve serioze të të burgosurit, Institucioni, njofton menjëherë familjarët ose të afërmit dhe në çdo rast, çdo person tjetër të caktuar më parë nga i burgosuri.
2. I burgosuri duhet të njoftohet menjëherë për vdekjen dhe sëmundjen e familjarëve dhe të afërmeve të tij.

Neni 113

Veprimet në rast vdekjeje

1. Në rast vdekjeje të të burgosurit institucioni merr masa për kryerjen e procedurave ligjore, që kanë të bëjnë me verifikimin e rastit, shkakun e vdekjes, kryerjen e veprimeve procedurale hetimore, si dhe veprimeve të tjera për sqarimin dhe dokumentimin e faktit të vdekjes.
2. Institucioni njofton menjëherë D.P.B, prokurorin, familjarët dhe në mungesë të familjarëve, autoritetet e gjendjes civile.
3. Sendet personale dhe depozitat në të holla të të burgosurit i dorëzohen familjarëve, sipas procedurave dhe dokumentacionit përkatës.
4. Në qoftë se brenda 6 (gjashtë) muajve nga vdekja e të burgosurit sendet e tij nuk janë tërhequr nga familja ose të afërmit e tij, ato dërgohen në organet e qeverisjes vendore të vendbanimit të tij.
5. Në rast se i burgosuri i vdekur nuk merret nga familja ose të afërmit e tij, personeli i institucionit kujdeset me organet e pushtetit vendor për varrosjen e tij në varrezat publike, duke përballuar shpenzimet e nevojshme dhe duke bërë shënimin e duhur në regjistrin themeltar.

KREU XV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 114

Mbrojtja shtesë e të paraburgosurve

1. Në asnjë rast të paraburgosurit nuk trajtohen si të dënuar, ose si persona që mund të dënohen në të ardhmen.
2. Të paraburgosurit gëzojnë të drejtat dhe detyrimet që gëzojnë të dënuarit me burgim për atë sa nuk parashikohet ndryshe në këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi.

3. Të paraburgosurit lejohen të informojnë menjëherë familjen për vendndodhjen e tyre. Atyre u krijohen të gjitha kushtet e nevojshme të takohen me familjarët, me përjashtim të rasteve kur kjo pengon, ose nuk është në interes të zhvillimit të hetimit dhe gjykimit.
4. Drejtori i institucionit kufizon të drejtën e të paraburgosurve për të pritur vizita, për të kryer letërkëmbim, apo për biseda telefonike, kur është e nevojshme, për kryerjen e veprimeve procedurale penale të urdhëruara nga organi procedues përkatës.

Neni 115

Këshillimi ligjor

Të burgosurit informohen në çdo rast për të drejtën për të përfituar këshillim ligjor dhe ju krijohen procedura lehtësuese që ata të takohen me mbrojtësit ligjorë dhe të përgatitin mbrojtjen përgjatë gjithë gjykimit.

Neni 116

Ndihma juridike

1. Të burgosurit informohen në çdo rast për të drejtën për të përfituar ndihmë juridike të garantuar nga shteti, nëse mbrojtja është e detyrueshme ose nuk ka mundësi financiare për të pasur një mbrojtës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.
2. Mjediset ku mbahen të burgosurit duhet të ofrojnë mundësinë që ata të takohen privatisht dhe të komunikojë me mbrojtësit dhe të kenë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen përgjatë gjithë gjykimit.
3. Të burgosurve të mitur ju garantohet ndihmë juridike dhe psikologjike, si dhe ushtrimi i të gjithë të drejtave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

Neni 117

Lirimi i të paraburgosurve

1. Lirimi i të paraburgosurit urdhërohet nga gjykata ose prokuroria.
2. Në rastet kur i burgosuri i liruar nuk ka mundësi strehimi ose transporti pranë familjes së tij, drejtori i institucionit, në bashkëpunim me institucionet vendore, si dhe organizatat e tjera, mundësojnë sistemimin dhe transportin e tij.
3. Në rast pamundësie objektive të të burgosurit për t'u larguar nga institucioni pas lirimimit, me kërkesën e tij, IEVP-ja mundëson strehimin në institucion, jashtë regjimit të brendshëm deri në përfundimin e pengesës për largim.
4. Personeli menjëherë pas lirimimit të të paraburgosurit apo të të dënuarit, plotëson të dhënat në sistemin MISP si dhe njofton policinë dhe prokurorinë për ekzekutimin e vendimit penal.

Neni 118

Dispozita kalimtare

Rregulloret e brendshme të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, të miratuara me Urdhër numër 5391/1 datë 22.06.2010; 5390/1 datë 22.06.2010; 5395/1 datë 15.06.2010; 5402/1 datë 15.06.2010; 5397/1 datë 22.06.2010; 5393/1 datë 22.06.2010; 5396/1 datë 22.06.2010; 5392/1 datë

22.06.2010; 7157/3 datë 03.12.2012; 5394/1 datë 22.06.2010; 5400/1 datë 22.06.2010; 5403/1 datë 22.06.2010; 5387/1 datë 22.06.2010; 5389/1 datë 22.06.2010; 5401/1 datë 22.06.2010, shfuqizohen.

Neni 119

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas datës së miratimit.